

Modalitetet e llogaridhënies me përfshirjen e Vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë

Grupit Punues me qëllim të hartimit të modaliteteve dhe skenarëve për çështje të reformës në sistemin e drejtësisë me qëllim të adresimit të llogaridhënies duke përfshirë edhe procesin e Vetingut

15 Dhjetor 2020

Në këtë raport kanë kontribuar:

1. Florent Spahija – Instituti Demokratik i Kosovës KDI – Kryesues
2. Ardit Orana – Zyra e kryeministrit të Kosovës – udhëheqës i nëngrupit I
3. Genc Nimoni – Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet ÇOHU! – udhëheqës i nëngrupit II
4. Labinot Leposhtica – Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuese BIRN – udhëheqës i nëngrupit III
5. Agim Maliqi – Gjyqtar në Gjykatën Supreme
6. Bahri Hyseni – Prokuror – Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës
7. Behar Ejupi – Avokat – Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës
8. Besim Kelmendi – Prokuror – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
9. Eris Hana – Ministria e Drejtësisë
10. Faton Bajrami – Gjyqtar – Gjykata Themelore në Prishtinë
11. Gzim Shala – Instituti i Kosovës për Drejtësi IKD
12. Haxhi Derguti – Gjyqtar – ud Kryeprokuror në Prokurorinë e Apelit
13. Kujtim Munishi – Prokuror – Kryeprokuror në Prokurorin Themelore në Prishtinë
14. Noliana Kusari – Ministria e Drejtësisë
15. Nora Bajrami – Lëvizja FOL
16. Qerim Ademaj – Gjyqtar – Anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykata e Apelit
17. Riza Shillova – Policia e Kosovës
18. Sefer Goxhuli – Agjencia Kosovare e Inteligjencës

Anëtarët e tjerë pjesëmarrës në takime:

1. Përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
2. Përfaqësues nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
3. Përfaqësues nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar
4. Përfaqësues nga Ambasada e Gjermanisë
5. Përfaqësues nga Ambasada e Italisë
6. Përfaqësues nga Misioni i OSBE-së

Përmbajtje

HYRJE	6
1. HISTORIKU DHE TRANZICIONI	8
1.1 Kompetencat të përziera	8
1.2 Periudha e parë gjatë fazës së administrimit nga UNMIK	8
1.3 Korniza Kushtetuese dhe Ligjore	9
1.4 Sistemi i Drejtësisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës	12
1.5 Drejtësia vendore ne raport me Misionin e Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje – Misioni EULEX	13
1.6 Procesi i emërimit/riemërimit – vettingu 2010	14
2. KORNIZA LIGJORE AKTUALE	18
3. SFIDAT E SISTEMIT TË DREJTËSISË	24
3.1 Integriteti	24
3.1.1 Ndikimet politike/grupeve të interesit	24
3.1.2 Çështja e emërimit dhe riemërimit/rekrutimit	28
3.2 Llogaridhënia	30
3.2.1 Menaxhimi i lëndëve – parashkrimi	30
3.2.2 Mungesa e performancës (performanca profesionale): Mos përgatitja e prokurorëve dhe performanca e gjykatësve	34
3.2.3 Shkeljet e afateve ligjore-procedurale	37
3.2.4 Mekanizmat e performancës së KPK dhe KGjK	40
3.3 Masat dhe avancimet	42
3.3.1 Rezultatet e mekanizmave të performancës dhe disiplinimit	42
3.3.2 Vlerësimi i Performancës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve	43
4. MODALITETET E LLOGARIDHËNIES DUKE PËRFSHIRË EDHE VETINGUN	47
4.1 Opsioni i - <i>Status Quo</i>	47
4.2 Opsioni II - Ndryshimet ligjore dhe kushtetuese	49
4.2.1 Ndryshimet konkrete ligjore në sistemin Prokurorial	49
4.2.2 Ndryshimet ligjore për gjyqësorin	53
4.2.3 Propozimi për Gjyqësorin	55
4.3 Opsioni i kombinuar: Krijimi i mekanizmave për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ndryshimet ligjore për disiplinimin dhe performancën e tyre.	55
4.3.1 Veting	57

4.3.2. Ndryshimet ligjore lidhur me vlerësimin e performancës dhe procedurën disiplinore	62
4.4 Opsioni IV - Vetingu	65
4.4.1 Paracaktimi i objektivave të procesit të Vetingut	65
4.4.2 Modeli i Vetingut	68
4.4.3 Domosdoshmëria e procesit të vetingut	73
PËRFUNDIMI	77

Shkurtesat

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KGjK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

MD – Ministria e Drejtësisë

Qeveria – Qeveria e Republikës së Kosovës

Kushtetuta – Kushtetuta e Republikës së Kosovës

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

Ambasada Amerikane – Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

KKGj - Komisioni Këshillues Gjyqësor

KGjPK - Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës

PSh – Prokuroria e Shtetit

PSRK – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

OAK – Oda e Avokatëve të Kosovë

OJQ – Organizatat e Shoqërisë Civile

HYRJE

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit janë ndër vlerat kryesore kushtetuese të Republikës së Kosovës. Mbrojta e këtyre vlerave është parakusht për shtet funksional dhe demokratik. Gardianë në këtë drejtim, janë organet e drejtësisë, të cilat sigurojnë që të gjithë që bien në kundërshtim me ligjin, mbahen përgjegjës.

Dhënë një detyrë kaq madhore, organet e drejtësisë, duhet të jenë në pedestalin më të lartë të llogaridhënies dhe integritetit.

Në shërbim të këtij ideali, në korrik të këtij viti, Qeveria e Republikës së Kosovës themeloi një mekanizëm *ad hoc*, i cili do adresonte problematikat e identifikuar deri më tani dhe do paraqiste alternativë për përmirësimin e gjendjes në sistemin e drejtësisë.

Ky Raport është produkt i punës së këtij grupi punës, dhe ka për qëllim të adresoj reformën në drejtësi me qëllim që të sigurohet llogaridhënia e nevojshme në kuadër të gjyqësorit dhe prokurorit të shtetit në Kosovë.

Më konkretisht, përmes këtij Raporti adresohen modalitetet dhe skenarët që do shpienin në funksionalizimin e një sistemi llogaridhënës të drejtësisë, duke mos përjashtuar si mjet për arritjen e këtij synimi as *vetting*-un.¹

Nevoja për të ndërmarrë veprime në drejtim të adresimit të problemeve të sektorit të drejtësisë është ekzistente tash e një kohë të gjatë. Pavarësisht progresit të arritur deri më tani sa i përket formimit dhe funksionalizimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë, ende vlerësohet nga instanca të shumta vendore dhe ndërkombëtare se sistemi i drejtësisë në vend karakterizohet nga keqfunksionimi. Hiç më mirë nuk është as perceptimi në sytë e qytetarëve, ku për shumë vite me radhë matjet e realizuara flasin për besim tej masë të munguar të qytetarëve në drejtësi.

Është e qartë se Republika e Kosovës që nga paslufta e pastaj pavarësia është përballur në vazhdimësi me ndryshime sa i përket kornizës ligjore dhe institucionale në sistemin e drejtësisë, të cilat ndryshime kanë ndikuar në funksionimin dhe mbarëvajtja e punës të organeve të drejtësisë.

Mirëpo, mungesa e rezultateve nga gjyqësori dhe prokuroria shkon përtej pengesave në adaptim me ndryshimet ligjore dhe institucionale. Për gjatë viteve, sistemi i drejtësisë karakterizohet nga mungesa e integritetit personal të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe njëkohësisht mungesa e performancës profesionale të tyre.

¹ Vettingu është procesi përmes të cilit skenohet, vlerësohet dhe verifikohet integriteti, etika e gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë por pa u kufizuar në të kaluarën, pasurinë, lidhjet eventuale me politikën, grupet e interesit dhe karakteristika të tjera në kuadër të integritetit dhe etikës.

Shtuar kësaj që përkundër gjitha problemeve të identifikuar, llogaridhënia përbrenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial ende nuk është parë të përmirësohet.

Ky Raport elaboron të gjitha këto problematika dhe orvatet të gjej alternativa që do përmirësonin funksionimin e sistemit të drejtësisë, si dhe racionalizon me nevojën e operimit të alternativave të konsideruara më të përshtatshme. E gjithë kjo për të krijuar besimin qytetar në sistem dhe për të avancuar tutje demokracinë në vend.

Në pjesën e parë të Raportit paraqitet një skanim i legjislacionit vendor në dispozicion, me relevancë për sistemin e drejtësisë, integritetin dhe llogaridhënien aty.

Pjesa e dytë nënvijëzon sfidat të cilat janë shkaktare të gjendjes aktuale në të cilën ndodhen organet e drejtësisë në termat e llogaridhënies.

Ndërkaq, pjesa e tretë, prezanton tutje tre opsione, gjegjësisht skenarë të cilët mund të operohen lidhur me llogaridhënien në sistemin e drejtësisë dhe njëkohësisht shpalos benefitet dhe të metat që përcjellin zgjedhjen e secilit opsion.

Ndërsa opsioni i parë flet për vazhdim të gjendjes aktuale, përkatësisht mos inicimin e asnjë veprimi shtesë në drejtim të përmirësimit të llogaridhënies në fushën e drejtësisë, opsioni i dytë, tretë dhe katërt parashohin ndërmarrjen e hapave aktiv për të atakuar mungesën e llogaridhënies në kuadër të sistemit.

Më hollësisht, opsioni i dytë analizon mundësinë e përmirësimit të llogaridhënies përmes ndryshimeve legjislative, opsioni i tretë parasheh mundësinë e adresimit të të metave në llogaridhënie, përmes masave të kombinuara, përkatësisht, vetingut në njërën anë dhe përmirësimit të performancës dhe disiplinimit përmes ndryshimeve ligjore në anën tjetër. Së fundi, opsioni i katërt elaboron se si do adresohet mungesa e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë përmes *vetting*-ut.

1. HISTORIKU DHE TRANZICIONI

1.1 Kompetencat të përziera

Sistemi i drejtësisë në Kosovën e pas luftës fillon të ndërtohet nga viti 1999, nisur me rregulloret e UNMIK-ut për të kulmuar me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe më pas ligjeve përkatëse në drejtësi. Sfidë e sistemit të Drejtësisë në Kosovës në vazhdimësi kanë qenë kompetencat e përziera të drejtësisë në mes të strukturave vendore dhe atyre ndërkombëtare. Fillimisht kjo është shprehur gjatë kohës së Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë UNMIK për të vazhduar më pas edhe gjatë Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë EULEX. Dualizmi i kompetencave është shprehur në aspektin legjislativ por edhe në atë institucional dhe operacional.

Aspekti i kompetencave midis institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ndahet në dy periudha të rëndësishme të historisë së sistemit të drejtësisë në Kosovë, periudha nën administrimin e Administratës së Kombeve të Bashkuara e cila zgjatë deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe periudha pas shpalljes së pavarësisë, miratimit të Kushtetutës dhe vendosjes së Misionit të BE-së në Kosovë EULEX.

1.2 Periudha e parë gjatë fazës së administrimit nga UNMIK

UNMIK-u si mision i Kombeve të Bashkuara u vendos në Kosovë për të shërbyer si prezencë ndërkombëtare civile dhe ushtarake pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 në qershor të vitit 1999. Kjo ishte periudhë kur kishte nevojë urgjente për të ndërtuar sundim të ligjit në Kosovë.

Më 28 qershor të vitit 1999, nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), kishte themeluar Këshilli i Përbashkët Këshillëdhënës mbi emërimet e përkohshme gjyqësore (KPK) për të rekomanduar emërimin e përkohshëm të gjykatësve dhe prokurorëve për një sistem emergjent të drejtësisë (SGJE).

UNMIK themeloi në korrik të vitit 1999 Departamentin e Çështjeve Gjyqësore (DOJ), i cili më vonë u bë Departamenti i Drejtësisë (DD) në vitin 2001. Mandati kryesor i DD ishte të ndërtonte një gjyqësor shumetnik, të pavarur, të paanshëm dhe kompetent, duke siguruar ndjekjen penale dhe dënimin e krimeve të organizuara me mbështetjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë. Shërbimet e prokurorisë dhe seksioni i administrimit të gjykatave në DD kanë luajtur rol udhëheqës në krijimin e më shumë se 60 gjykatave dhe prokurorive publike në mbarë Kosovën me përafërsisht 1,500 gjyqtarë, prokurorë dhe personel gjyqësor administrativ.²

² Shënim: DD u zgjerua për të përfshirë Njësine për politika ligjore ; Sektorin për zhvillime gjyqësore, Zyrën për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, dhe Zyrën e prokurorëve ndërkombëtarë/Sektori penal, që mandate kryesor kishte hetimin e krimeve të luftës dhe atyre me motive ndëretnike. Përveç kësaj, DD funksionalizoi tetë objekte korrektuese dhe ndihmoi në themelimin e Departamentit për çështje ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Më konkretisht me vendimin e PSSP, KPK u shpërbë më 7 shtator të vitit 1999 dhe u zëvendësua nga Komisioni Këshillues Gjyqësor (KKGJ), i cili filloi aktivitetin e tij më 27 tetor të vitit 1999. Më 11 dhe 12 dhjetor 1999, pas pranimit të më tepër se 700 aplikacioneve dhe mbajtjes së përafërsisht 560 intervistave, KKGJ i dërgoi PSSP-së rekomandimet për emërim për më tepër se 300 gjykatës dhe prokurorë dhe për më shumë se 200 gjykatës porotë.

Inkuadrimi i parë i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në gjyqësi, kishte filluar kur PSSP, kishte miratuar Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6, e cila siguronte emërimin e një gjykatësi dhe prokurori ndërkombëtar në Mitrovicë. Më 29 maj të vitit 2000, PSSP më pas miratoi Rregulloren 2000/34, e cila zgjeron autorizimet për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në tërë territorin e Kosovës.³

Në janar të vitit 2001, autorizimet e prokurorëve ndërkombëtar për të marrë rastet ishte forcuar edhe më tepër me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/2, e cila thotë se: prokurori ndërkombëtar mund të ndërmarë, apo vazhdon ndjekjen e rastit duke i përdorur procedurat e aplikueshme për ndjekjen nga ana e palës së dëmtuar.

Në Prill 2001, PSSP-ja themeloi Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK), i cili zëvendësoi Komisioni Këshillues Gjyqësor që kishte pushuar së funksionuari në Dhjetor të vitit 2000.⁴

Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJPK), ka funksionuar deri në themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

1.3 Korniza Kushtetuese dhe Ligjore

Në vitin 2001 kemi fillimin e sistemi i drejtësisë në kuadër të Kornizës Kushtetutës për Vetëqeverisje në Kosovë⁵ e cila periudhë zgjatë deri më 2008 kur krijohet sistemi i drejtësisë në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁶

Korniza Kushtetuese e Kosovës në Pjesën e 4 parasheh sistemin gjyqësor ku ka rregulluar Administrimin e Drejtësisë, strukturën e gjykatave procedurat gjyqësore, gjykatësit dhe prokurorët, Prokurorinë publike, kolegjin e veçantë të Gjykatës Supreme. Në kuadër të kornizës kushtetuese është paraparë se gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë do të

³Rregullore nr. 2000/34, UNMIK/REG/2000/34; 27 maj 2000;

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_34.htm.

⁴Shënim: KGJPK-ja ishte përgjegjës për këshillimin e PSSP-së lidhur me çështjet e emërimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë, si dhe dëgjimin e ankesave dhe marrjen e veprimeve të caktuara disiplinore kundër çdo gjykatësi, prokurori dhe gjyqtari porotë. KGJPK përbëhej nga nëntë anëtarë lokal dhe ndërkombëtarë, të përzgjedhur dhe emëruar nga PSSP-ja.

⁵Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë - RREGULLORE NR. 2001/9 - http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf;

⁶Shënim: Që nga aktet e para juridike me të cilat është themeluar sistemi i drejtësisë në Kosovë është paraparë ekzistenca e strukturave ndërkombëtare të drejtësisë të cilët në fillim edhe kanë pasur rolin e themelimit dhe zhvillimit të sistemit të drejtësisë por që më pas edhe punën e përbashkët me strukturat vendore.

veprojnë brenda sistemit gjyqësor në përputhje me rregullat e vendosura nga PSSP-ja.⁷ Gjykatësit dhe Prokurorët emërohen nga PSSP pas propozimit të Këshillit të gjyqësisë dhe i prokurorisë së Kosovës dhe të miratuara nga Kuvendi.

Ky rregullim ligjor është paraparë në rregulloret e UNMIK-ut siç janë:

- Rregullorja Nr. 1999/6 1999 Për Rekomandimet mbi Strukturën dhe Administrimin e Shërbimit të Gjyqësisë dhe të Prokurorisë e miratuar më 7 shtator.⁸
- Rregullore Nr. 1999/7 Për emërimin dhe shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.⁹
- Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.¹⁰

Në Maj 2001, PSSP-ja nxori Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese), e cila parashihte krijimin e institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) përfshirë edhe sistemin e drejtësisë. UNMIK ruajti përgjegjësinë në fushën e drejtësisë duke përcaktuar se gjyqtarët dhe prokurorët emëroheshin nga PSSP-ja me propozim të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGjPK) dhe të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjithashtu, vendimet për transferimin, ngritjen në pozita dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të merren nga PSSP-ja bazuar në rekomandimet e KGjPK-së apo me vetiniciativë të këtij të fundit. Krahas kësaj për qëllime të administrimit të kompetencave të rezervuara në fushën e drejtësisë, PSSP-ja kishte themeluar "Shtyllën e Parë e quajtur për Policinë dhe Gjyqësinë e udhëhequr nga ndërkombëtarët. Krijimi i Shtyllës së parë të UNMIK i mundësoi këtij misioni të krijojë shumë akte legislative për të luftuar krimet e rënda, terrorizmin, krimet e luftës, krimin e organizuar etj si kompetencë e gjykatësve dhe prokurorët ndërkombëtarë.

Në vitin 2004, UNMIK-u kishte ndërmarrë një rishikim të plotë të kompetencave të veta dhe kishte identifikuar një numër të madh të përgjegjësive që mund të ju transferoheshin IPVQ-ve. Si rezultat kësaj u themelua Ministria e Drejtësisë në vitin 2005, si pjesë e Qeverisë së IPVQ.

Përveç Ministrisë së Drejtësisë, UNMIK-u në vitin 2005 themeloi edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK) si organ nën autoritetin e PSSP-së dhe duke trashëguar Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. KGjK-ja në atë kohë përbëhej nga 11 anëtarë, prej të cilëve 7 ishin gjyqtarë (duke përfshirë 2 gjyqtarë ndërkombëtarë) dhe 4 anëtarë tjerë të cilët nuk ishin gjyqtarë.

⁷Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë - RREGULLORE NR. 2001/9 - http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf.

⁸Kjo rregullore parashihet Komisionin i cili përbëhet nga dhjetë anëtarë vendas dhe pesë anëtarë ndërkombëtarë, të zgjedhur në bazë të ndershmërisë, aftësive profesionale dhe përvojës...

⁹Më shumë: <https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A1999regs/A1999regs.htm>.

¹⁰Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë - RREGULLORE NR. 2001/9- http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf.

Ndonëse Këshilli Gjyqësor kishte një mori detyrave dhe përgjegjësi,¹¹ PSSP-ja edhe më tutje mbajti autoritetin përfundimtar lidhur me emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve.

PSSP-ja i transferoi në Prill të vitit 2006 më tepër përgjegjësi Ministrisë së Drejtësisë.¹²

UNMIK-u në Shtator të vitit 2006 themeloi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK) si një njësi përbërëse e Divizionit Penal të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut. ZPSK përbëhej nga prokurorë ndërkombëtar dhe lokal të caktuar nga PSSP-ja. ZPSK ishte përgjegjëse për ndërtimin e kapaciteteve në Zyrën e Prokurorit Publik përmes trajnimit dhe këshillimit të Prokurorëve Special me qëllim të rritjes së aftësisë së tyre për të ndjekur penalisht veprat më të rënda penale në Kosovë.¹³

Në Dhjetor të vitit 2006, pas përgatitjeve të gjata dhe ende në pritje të marrëveshjeve përfundimtare për financimin dhe zbatimin e tij, PSSP-ja themeloi Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGjP) si organ i pavarur i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), me qëllim të shqyrtimit të përnjëhershëm dhe gjithëpërfshirës në mbarë Kosovën të përshtatshmërisë së të gjithë kandidatëve për emërim të përhershme në postin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë.

Nga studimet e kohës dhe analizat e kësaj periudhe nga organizata të ndryshme konstatohet se Sistemi i drejtësisë mbetet thellësisht i fragmentuar ndërmjet elementeve vendore dhe atyre ndërkombëtare. Deri diku ka pasur një progres të caktuar në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve dhe gjykatësve vendas me homologet e tyre

¹¹Shënim: KGjK-ja ishte përgjegjëse për: Përcaktimin e politikave administrative dhe sigurimin e mbikëqyrjes administrative për gjyqësinë dhe gjykatat; Vendosjen e politikave dhe shpalljen e rregullave dhe udhëzimeve për gjyqësinë dhe gjykatat duke përfshirë rekrutimin, trajnimin dhe emërimin, vlerësimin, promovimin, transferimin dhe disiplinën të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe të personelit tjetër gjyqësor dhe jo-gjyqësor; Ushtrimin e përgjegjësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave; Vendosjen e vendndodhjes gjeografike, numrin dhe strukturën e gjykatave në konsultim me Kuvendin e Kosovës; Ushtrimin e përgjegjësi në lidhje me sigurimin e kërkesave teknike dhe financiare, personelit mbështetës dhe burime materiale për të siguruar funksionim efektiv të sistemit gjyqësor; Krijimi i politikave dhe ofrimi i trajnimeve për personelin gjyqësor, duke përfshirë trajnimin profesional dhe ngritjes së aftësisë, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Kosovës, në tërësi ose pjesërisht me anë të Institutit Gjyqësor të Kosovës ("IGJK-ja"); Ushtrimin e përgjegjësi në lidhje me organizimin e provimeve për kualifikimin e gjyqtarëve nëpërmjet IGJK-së; ushtrimin e përgjegjësi në lidhje me emërimin, trajnimin, disiplinimin dhe largimin e anëtarëve të personelit ndihmës gjyqësor; Sipas nevojës sigurimi i informacionit dhe statistikave për sistemin gjyqësor, duke përfshirë bashkëpunimin me organizatat përkatëse sa i përket monitorimit të pavarur të sistemit gjyqësor, dhe Mbrojtja e të dhënave personale lidhur me sistemin gjyqësor.

¹²Shënim: Disa nga përgjegjësitë ishin: Hartimin e politikave brenda fushës së përgjegjësi të saj, për të lehtësuar përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, duke përfshirë prokurorinë publike, duke përjashtuar çështjet që lidhen me administrimin e gjyqësorit dhe të gjykatave; Menaxhimin e çështjeve administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë, dhe zhvillimin e rregullave administrative, teknike dhe financiare dhe rregullat e personelit ndihmës dhe burimet materiale për funksionim efektiv të sistemit të prokurorisë, pa ndërhyrë në asnjë mënyrë në veprimet e Zyrës së Prokurorit Publik dhe në zbatimin e hetimeve penale, etj.

¹³Shënim: ZPSK kishte poashtu juridiksionin në krimet më të rënda në Kosovë, duke përfshirë por jo kufizuar në rastet e krimit të organizuar, korrupsionit, veprave penale të motivuara nga pikëpamjet raciale, përkatësia nacionale, etnike, apo fetare, terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Prokurorët special që punonin brenda ZPSK nën mbikëqyrjen apo monitorimin e prokurorëve ndërkombëtarë ishin të autorizuar të kryenin funksionet e tyre në tërë Kosovën.

ndërkombëtare. Mungesa e një sistemi të integruar e ulë efikasitetin e tij dhe vështirëson përpjekjet për të rritur aftësitë e prokurorëve dhe gjykatësve vendas.¹⁴

Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës edhe pse u themeluan në vitin kishin kompetenca të kufizuara.

1.4 Sistemi i Drejtësisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Me shpalljen e pavarësisë dhe miratimin e Kushtetutës së Kosovës fillon edhe miratimi i ligjeve tjera të cilat rregullojnë sistemin e drejtësisë. Me këtë fillon një etapë e re e kompletimit, tranzicionit dhe mvetësimit të sistemit të drejtësisë në Kosovës. Edhe kjo periudhë karakterizohet me një rol të madh të strukturave ndërkombëtare dhe më një tranzicion të ngadalshëm i cili zgjatë deri në vitin 2018 kur përgjegjësitë ekzekutive në tërësi barten tek institucionet e drejtësisë vendore.

UNMIK-u u ristrukturua në vitin 2008 dhe detyrat e tij ekzekutive në sundimin e ligjit u bartën tek Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), në pajtim me deklaratën e Kryetarit të Këshillit të Sigurimit më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44).

Këshilli Gjyqësor gjatë kohëzgjatjes së mandatit të Prezencës Ndërkombëtare Civile, ka pasur një përbërje të përzier.¹⁵

Njëra ndër masat e para legislative pas shpalljes së pavarësisë ishte themelimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si zyrë e përhershme dhe e specializuar prokuroriale që operon nën ombrellën e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës.¹⁶

Një ndër të arriturat për fuqizimin e kornizës institucionale të shërbimit të prokurorisë ishte themelimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe rregullimi i funksioneve të Prokurorit të Shtetit në Tetor 2010.¹⁷

¹⁴ Raporti i Human Rights Watch mbi të dhënat e përgjithshme mbi të drejtën penale në Kosovë, mars 2008, volumi 20)

¹⁵Shënim: Pesë (5) anëtarë janë anëtarë kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, që janë verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si pjesë e fazës së parë dhe të dytë të procesit të emërimit, Tetë (8) anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë, përveç dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të jenë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtës. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë ishte gjyqtar.

¹⁶Shënim: Kjo zyrë është paraparë të ketë dhjetë prokurorë publik të Kosovës dhe prokurorë shtesë sipas nevojës. Për më shumë, kjo zyrë do të përbëhet prej pesë prokurorëve të EULEX-it gjatë kohëzgjatjes së pranisë së misionit ndërkombëtar në Kosovë dhe rrjedhimisht për një kohe te gjate do të udhëhiqej nga Kryeprokurori i EULEX-it.

¹⁷Shënim: Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Prokurorial të Kosovës janë si më poshtë: të siguruarit që prokurorët veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale; rekrutimin dhe propozimin tek Presidenti të kandidatëve për emërim dhe rrimërim në prokurori, përfshirë kandidatët nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë; të siguruarit se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit; propozimi i kandidatëve tek Presidenti për emërim si Kryeprokuror të Shtetit; në bashkëpunim në Institutin Gjyqësor të Kosovës, themelon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit përgatitor për kualifikimin e prokurorëve

Pas vendosjes së bazave të reformimit të sistemit publik prokurorial, hapat e ardhshëm konkret për reformim e gjyqësorit u prezantuan në Gusht të 2011. Sistemi gjyqësor bazuar në Ligjin për Gjykatat përfshinë: Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Gjykatat Themelore janë gjykata të shkallës së parë të Republikës së Kosovës. Gjykatat themelore kanë përgjegjësi të shqyrtojnë të gjitha rastet në shkallën e parë përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. Gjykata e Apelit është e vendosur në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë që ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës

1.5 Drejtësia vendore ne raport me Misionin e Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje – Misioni EULEX

Në shkurt të vitit 2008, Këshilli Evropian i Ministrave të Jashtëm miratoi një plan të përbashkët për ta themeluar misionin evropian për sundimin e ligjit në Kosovës (EULEX). Mandati i EULEX-it ishte të monitorojë, mentorojë dhe këshillojë institucionet e Kosovës në sferën e sundimit të ligjit dhe të hulumtojë kategori të caktuara të krimeve të rënda.¹⁸

Misioni i EULEX-it do të ishte përgjegjës për mentorimin, këshillimin dhe monitorimin e autoriteteve të Kosovës në sferën e sundimit të ligjit dhe do të kishte funksione të caktuara ekzekutive në sferën e gjyqësisë, policisë, kontrollit të kufirit, doganave dhe shërbimit korrektues duke përfshirë hetimin e rasteve të krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, krimeve ekonomiko-financiare dhe krime të tjera të rënda.

Në mars 2008 u miratua Ligji i cili rregullon përfshirjen dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës.¹⁹ Kompetencat e EULEX-it sipas këtij ligji ishin mjaftë të gjera.²⁰

Tutje mandati i EULEX vazhdon të rregullohet me ndryshime të vazhdueshme ligjore, me atë të 23 prillit 2014 me miratimin e Ligjit për mandatin e EULEX-it për ndryshimin dhe

¹⁸Shënim: Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë përzgjidhen nga misioni i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (ESDP).

¹⁹Më shumë: <https://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=eulex&so=1>.

²⁰Shënim: Disa nga Kompetencat e EULEX-it sipas këtij ligji ishin: sulm kundër rendit juridik të Kosovës; nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik; rrëmbimi i fluturakes; rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil; rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar ; rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosur në pragun kontinental; d) piratëria; kontrabandimi me emigrantë ; Trafikimi me njerëz; rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to; vrasja; vrasja e rëndë; Marrja e pengjeve ; Rrëmbim i personit; shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës; tortura; të gjitha veprat penale kundër integritetit seksual të paraqitura në nenet çdoherë që ato janë të dënueshme me pesë ose më tepër vite burgim, etj.

plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës;²¹si dhe me ndryshimet tjera pasuese.²²

Sipas këtij rregullimi ligjor në rrethana të jashtëzakonshme me kërkesë të arsyetuar të Kryeprokurorit të Shtetit, Këshilli Prokurorial mund të vendosë që çështja penale t'i caktohet një prokurori të EULEX-it, në pajtim me autoritetin kompetent të EULEX-it. Përjashtimisht nga kjo në rrethana të jashtëzakonshme, Autoriteti Kompetent i EULEX-it, për arsye specifike të bazuara mund të propozoj që një rast t'i caktohet një Prokurori të EULEX-it. Pas shqyrtimit dhe rekomandimit të Komisionit të përbërë nga Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të vendos për caktimin e rastit tek Prokurori i EULEX-it.

Në vitin 2018 një numër i rasteve të cilat kanë qen kompetencë e EULEX-it janë transferuar në institucionet vendore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ishte miratuar dhe kishte hyrë në fuqi në vitin 2008, me ç' rast kishte paraparë organe dhe funksione të reja në drejtësi duke shtuar kështu nevojën për ligje të reja në fushën e drejtësisë. Me kushtetutë janë themeluar, rregulluar dhe funksionalizuar institucione të reja të drejtësisë, ndër të tjera Këshilli Prokurorial i Kosovës, ai Gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese.²³Ndër ndryshimet me të theksuara janë ato të vitit 2013, me ç' rast Ligji për Gjykatat, Kodi i ri Penal dhe ai i Procedurës Penale, kishin ndryshuar edhe strukturën organizative të prokurorive dhe gjykatave.²⁴ Nga niveli komunal, i Qarkut dhe ai Suprem, prokuroritë dhe gjykatat ishin riorganizuar në nivelin Themelor, të Apelit dhe atë Suprem.²⁵ Ndryshimet e tilla edhe kishin rezultuar në gjykata me kompetenca të reja në regjione të caktuara, me ç' rast ishin themeluar gjykatat dhe prokuroritë themelore në Gjakovë dhe në Ferizaj.²⁶

1.6 Procesi i emërimit/riemërimit - vettingu 2010

Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) është krijuar si një organ i pavarur i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nga Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/2, e cila ka hyr në fuqi më 17 janar 2008.

²¹Shënim: Sipas këtij ligji Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në; si dhe Gjyqtarët e EULEX-it/ndërkombëtarë të caktuar në procedurat civile do të kenë kompetencë të gjykojnë rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin; rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014; rastet që bien nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Privatizimit; rastet që bien nën juridiksionin e Panelit të Apelit lidhur me vendimet e Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës sipas ligjit në fuqi. Më shumë: <https://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=mandatin%20e%20misionit&so=1>.

²²Po aty.

²³Më shumë: <https://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=kushtetuta&so=1>.

²⁴Ligji për Gjykatat - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700>

Ligji për Prokurorin e Shtetit - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>.

²⁵Po aty.

²⁶Po aty.

KPGJP-ja kishte mandatin për të vendosur për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërim të përhershëm si gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë.

Sipas urdhëresës administrative nr. 2008/2 procesi i emërimit të organizohej në tri faza të njëpasnjëshme.²⁷

- Faza e I-rë, e cila është fokusuar në përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatën Supreme dhe përzgjedhjen e prokurorëve për Prokurorinë e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale.
- Faza e II-të është përqendruar në përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatat e Qarkut, Gjykatën Ekonomike, për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje dhe për Prokuroritë e Qarkut.
- Faza e III-të, e cila është përqendruar në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve komunal.

Më 25 shkurt të vitit 2008 nënshkruhet një Memorandum Mirëkuptimi nga përfaqësuesi i Komisionit Evropian, Qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe UNMIK-u lidhur me verifikimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë.²⁸

Urdhëresës Administrative 2008/2 kishte përcaktuar se të gjithë kandidatët, pa përjashtim duhet ta kalojnë provimin mbi Kodet relevante të Etikës.²⁹ Kjo dispozitë e ligjit ka shpie drejtë vendimit të administrimit të testit të etikës për të gjithë kandidatët mu në fillim të Procesit të Emërimit. Për t'iu nënshtruar këtij provimi është organizuar aplikimi elektronik. Formulari i aplikimit paraprak 16-faqesh ka qenë i përbërë nga 25 pjesë të veçanta, secili ka mbuluar nga një aspekt tjetër të jetës së vet kandidatëve.³⁰

Gjerë më 19 prill të vitit 2009, afati i paraparë për aplikim, 898 kandidat kishin dërguar aplikacionet e tyre preliminare.

²⁷Urdhëresa Administrative nr. 2008/02 -

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2008ads/ADA2008_02.pdf.

²⁸Shënim: Ky Memorandum ka caktuar Zyrën për Shërbim të Projekteve të Kombeve të Bashkuara (UNOPS) si partner implementues të projektit. Projekti është financuar nga KE dhe SHBA.

Memorandumi i Mirëkuptimit ka paraparë krijimin e një Komiteti Drejtues. Detyrat e tij kanë konsistuar në : (a) përpilimin e rekomandimeve lidhur me punësimin e Drejtorit të Projektit, gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të cilët janë marr në konsiderim për emërim si Komisioner, (b) mbikëqyrjen dhe shqyrtimin mujor të progresit të përgjithshëm në zbatim të Projektit; (c) shqyrtimi dhe miratimi i formave dhe procedurave të zhvilluara nga KPGJP-ja.

²⁹Urdhëresa Administrative nr. 2008/02 -

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2008ads/ADA2008_02.pdf.

³⁰Shënim: Duke përcjellur standardet e rekrutimit një zyrtar nga Danimarka, u punësua si drejtor dhe një gjyqtari amerikan në pension, ishte zgjedhur si President. Detyrat e këtij menaxhmenti kanë qenë organizimi i publikimit dhe zyrtarizimi i projektit më 6 shkurt, 2009 si dhe krijimi dhe zbatimi i planeve lidhur me teknologjinë informative, burimet njerëzore, dhe procesin preliminar të aplikimit elektronik të kandidatëve.

Duke ndjekur procedurat standarde të punësimit, janë përzgjedhur më pas dhe emëruar katër Komisioner ndërkombëtarë. Anëtarët ndërkombëtarë të cilët fillimit kanë qenë të përfshirë në komision ishin nga Gjermania, Italia, Franca, dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në përgjithësi, prej 372 pozitive gjyqësore të shpallura, 274 gjyqtarë janë emëruar. Në përgjithësi, prej 89 pozitive prokuroriale të shpallura, janë emëruar 60 prokurorë.

Gjatë këtij procesi është krijuar një bazë e mirë për proceset e ardhshme nëse vendoset të vazhdohet me procesin e verifikimit/vetingut. Gjatë këtij procesi janë krijuar procedura, forma/formularë të vlerësimit, metodologji etj. të cilat mund të përdoren në të ardhmen nëse është e nevojshme.

Gjithashtu përvoja e krijuar në këtë proces është vlerë e shtuar për çfarëdo procesi në të ardhmen në këtë fushë qoftë për të mos përsëritur gabimet por edhe për të marrë anët pozitive të këtij procesi.

Në tabelën në vazhdim janë pasqyruar të dhënat e procesit nga tri fazat.

Faza	Pozitat e shpallura	Të emëruar	Riemërimet	Të emëruarit e rinjë	Femra	Minoritetet
Faza I	33	26 (78.79%)	9 (34.61%)	17(65.38%)	11 (42.31%)	1 (3.84%)
Faza II	109	86 (78.90%)	31 (36.04%)	55 (63.96%)	21 (24.4)	6 (6.97%)
Faza III	319	222 (69.59%)	92 (41.44%)	130 (58.56%)	63 (28.37%)	8 (3.60%)
Totali	461	334 (72.45%)	132 (39.52%)	202 (60.48%)	95 (28.44%)	15 (4.45%)

Nga analiza e këtij procesi në bazë të informacioneve në dispozicion mund të thuhet se ky proces ka pasur anët negative dhe pozitive, mirëpo i njëjti mund të shfrytëzohet në aspektin pozitiv, marr parasysh përvojat në këtë proces, disa prej të cilave të renditura si më poshtë:

- Përvoja e fituar në organizimin dhe administrimin e një procesi të tillë në mënyrë të sigurt përfshinë edhe përdorimin e teknologjisë së informacionit për të lehtësuar procesin;
- Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare për ti përdorur të dhënat e tyre për këtë proces;
- Shfrytëzimi i procedurave standarde te veprimit për verifikim/veting të secilit aplikant;
- Krijimi dhe shfrytëzimi i pyetjeve standarde për intervista te cilat mbulojnë te gjitha kriteret relevante te vlerësimit;
- Shfrytëzimi i formularëve standard të vlerësimit;
- Prosesi i verifikimit duhet të jetë i vazhdueshëm i përcjellë në periudha të caktuara kohore. Verifikimi nuk duhet të jetë i kryer njëherë dhe mos të vazhdohet në të ardhmen në periudha të caktuara kohore;
- Nga analiza e raportit përfundimtarë të këtij procesi konstatohet se procesi nuk ka përfshirë në mënyrë të duhur verifikimin e pronës, aspektin financiar- interesat financiare, të ardhurat dhe shpenzimet, punën e kaluara të aplikantit etj.

- Nuk është bërë verifikimi i personave të cilët janë të caktuar për të kryer verifikimin/vetingun, integriteti i të cilëve duhet të jetë në nivel të lartë.
- Nuk ka pasë kritere të sakta të vlerësimit të caktuara paraprakisht e në veçanti kriteret eliminuese për një kandidat. Këto kritere duhet të jenë të caktuara paraprakisht në mënyrë që të eliminohet mundësia e subjektivizmit në proces.

2. KORNIZA LIGJORE AKTUALE

Përgjatë dy dekadave të fundit, korniza ligjore që adreson sistemin e drejtësisë në Kosovë ka kaluar në një sërë reformash. Sot, organizimi struktural, funksional dhe modalitetet lidhur me llogaridhënien në sistemin e drejtësisë, gjejnë bazën ligjore në Kushtetutë dhe në një mori aktesh ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, korniza ligjore primare, e lidhur drejtpërdrejtë me çështjen nën trajtim të këtij Raporti, konsiston në aktet ligjore si në vijim:

Tabela e legjislacionit	
1.	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2.	Ligji Nr 06/L055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
3.	Ligji Nr 06/L056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
4.	Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat
5.	Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
6.	Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
7.	Ligji nr. 06/l-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
8.	Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve
9.	Ligji Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale
10.	Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë
11.	Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë
12.	Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë

13.	Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë
Legjislacioni dytësor / Rregulloret përkatëse	
14.	Rregullore (02/2020) për organizimin e brendshëm të Gjykatave
15.	Rregullore (03/2020) mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
16.	Rregullore (05/2016) për Rekrutimin, Testimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve
17.	Rregullore (11/2016) për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve
18.	Rregullore (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve
19.	Rregullore (04/2020) për Autoritetin, organizimin, dhe funksionimin e njësisë së inspektimit gjyqësor
20.	Rregullore (09/2016) për Emërimin, Shkarkimin dhe vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave
21.	Rregullore (02/2020) për organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës
22.	Rregullore (06/2019) për emërimin e Kryeprokurorit të shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës
23.	Rregullore (05/2015) për Punën e Komisionit Disiplinor
24.	Rregullore (07/2015) për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve të shtetit
25.	Rregullore (12/2015) për vlerësim të performancës së prokurorëve
26.	Rregullore (05/2019) për procedurën disiplinore të prokurorëve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

I dedikon Sistemit të Drejtësisë një kapitull të tërë, ku në kapitullin VII, të Kushtetutës normohen si kategori kushtetuese gjyqësori dhe prokurori i shtetit.

Kushtetuta përcakton që parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë udhëheq gjyqtarët dhe prokurorin e shtetit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Mandati fillestar për prokurorë dhe gjyqtarë, sipas kushtetutës, është tre (3) vjeçar, ndërkaq me rastin e riemërimit mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit. Po ashtu, në kuadër të Kushtetutës përcaktohen edhe dy skenarët që rezultojnë në shkarkimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve nga funksioni, e që janë: dënimi për vepër të rëndë penale ose mosrespektimi i rëndë i detyrave.

Në Kushtetutë, normohen edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) si kategori kushtetuese me përgjegjësinë për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të drejtësisë. Këshillat janë po ashtu të thirrur të rekrutojnë, propozojnë për emërim dhe riemërim, avancojnë, transferojnë, disiplinonjë dhe vlerësojnë performancën e prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Kushtetuta i jep hapësirë edhe procesit të emërimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, duke përcaktuar që propozimet për emërim duhet bërë në bazë të procesit të hapur dhe të bazuar në merita, ku të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Pavarësinë dhe paanshmërinë e të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës e siguron KGJK, si institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Ndërkaq organizimi dhe funksionet e këtij institucioni rregullohen me Ligj.

KGJK sipas këtij ligji është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare, siguron pavarësinë, mos diskriminimin, profesionalizmin dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor, siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të drejta, apolitike, të qasshme dhe profesionale, siguron që gjykatat të respektojnë parimet e mos diskriminimit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, siguron që gjykatat të pasqyrojnë natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës.

Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Ky ligj rregullon detyrat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e KPK-së si organ apo institucion përgjegjës për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së Sistemit Prokurorial të Kosovës.

Bazuar në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, KPK është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta dhe siguron që prokuroritë të pasqyrojnë natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës, siguron që të gjithë personat të kenë qasje të barabartë në drejtës, siguron që prokuroritë të respektojnë parimet e mos diskriminimit, proporcionalitetit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Ligji për Gjykatat

Në kuadër të këtij ligji normohet organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave në Republikën e Kosovës.

Ligji për Prokurorin e Shtetit

Ky ligj themelon dhe rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit.

Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

PSRK është themeluar si organ prokurorial të përhershëm dhe të specializuar e që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit, ku ndjek veprat penale me rrezikshmëri të lartë dhe të natyrës më komplekse.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Ky ligj përcakton shkeljet disiplinore, procedurat për fillimin e hetimeve për dyshimet për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedurat disiplinore pranë KGJK dhe KPK-së, sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike që lidhen me shkeljet disiplinore pranë Gjykatës Supreme.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.

Ligji për Akademinë e Drejtësisë

Akademia e drejtësisë e cila është kompetente për arsimimin ligjor dhe trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rregullohet dhe funksionon bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë. Tutje ligji ndër tjera, rregullon mënyrën dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe çështje të tjera.

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë

Rregullon detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, e po ashtu parasheh edhe kontrollin e pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre. Ligji në fjalë i obligon edhe anëtarët e KGJK dhe KPK, Drejtorin e Sekretariatit të KGJK, Drejtorin e Sekretariatit të KPK, Gjyqtarët dhe Prokurorët, të deklarojnë pasurinë e tyre.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë

Ka për qëllim të përcaktojë rregullat e sjelljes së gjyqtarëve në Republikën e Kosovës si dhe të vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të njëjtit ta kenë gjatë punës së tyre.

Pavarësia është një ndër parimet themelore që duhet të udhëheqë veprimtarinë e gjyqtarit. Duke u bazuar në këtë parim, gjyqtari duhet të ushtroj funksionin e tij në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, bazuar në Kushtetutë, ligj dhe në vlerësimin individual të fakteve, pa ndonjë kufizim, ndikim të padrejtë, nxitje, presion, kërcënim ose ndërhyrje, direkt ose indirekt, nga çdokush e për çfarëdo arsye, duke ruajtur dhe promovuar pavarësinë në aspektin individual dhe institucional.

Parimi i integritetit në këtë kod nënkupton detyrimin e gjyqtarit që të sillet në mënyrë të ndershme, të dinjitetshme dhe duhet të jetë gjatë tërë kohës në harmoni me karakterin e lartë moral, i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit të gjyqësorit. Gjyqtari duhet të sillet me integritet, si në jetën profesionale ashtu edhe në jetën personale, dhe nuk duhet të përdorë gjuhën e urrejtjes, të ketë sjellje të pahijshme apo të vrazhdë.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë

Ky akt përcakton standardet e sjelljes dhe etikën e prokurorëve, duke u bazuar në vlerat dhe parimet e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, të cilat janë: pavarësia, paanshmëria, integriteti, llogaridhënia, transparenca dhe profesionalizmi.

Kodi parasheh parimin e integritetit si parim themelor për ushtrimin e veprimtarisë së prokurorëve. Në kuptim të këtij kodi "integriteti është cilësi e prokurorit, e cila duhet të jetë e dukshme dhe e njohur gjatë tërë kohës në harmoni me veprimet e tij, të bazuara në

karakterin e lartë moral dhe profesional”. Të vepruarit me integritet për një prokuror do të thotë të jetë përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në jetën profesionale dhe private. Shkelja e integritetit mund të përfshijë një veprim ose mosveprim, qoftë gjatë ushtrimit të detyrës dhe në jetën private, që është në kundërshtim me ligjin, politikat dhe strategjitë e sistemit prokurorial, udhëzimet administrative, ose një veprim që përbën vepër penale.

Ndër të tjera, ky kod rëndësi te veçantë i kushton parimit të llogaridhënies dhe transparencës. Llogaridhënia dhe transparenca janë vlera themelore për prokurorin, të cilat nënkuptojnë kryerjen e detyrave me përgjegjshmëri, me nivel të lartë profesional, në mënyrë transparente dhe efikase. Prokurori duhet të japë llogari gjatë ushtrimit të funksionit dhe për mënyrën e ushtrimit të tij.

Aktet nën ligjore në fuqi për KGJK-në dhe KPK-në

Në tabelën e mësipërme janë përmendur disa nga aktet nënligjore të nxjerra dhe miratuara nga KGJK dhe KPK, të cilat janë të rëndësishme fillimisht për plotësimin e legjislacionit primar lidhur me organizimin e brendshëm gjyqësor e prokurorial, rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, punën e organeve disiplinore dhe të performancës si dhe rregulla të tjera.

3. SFIDAT E SISTEMIT TË DREJTËSISË

3.1 Integriteti

3.1.1 Ndikimet politike/grupeve të interesit

Kushtetuta dhe ligjet në masë të madhe garantojnë se sistemi gjyqësor është i pavarur. Disa dispozita ligjore kohët e fundit janë kontestuar për shkak se i kanë dhënë autoritet të tepruar Kuvendit në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK). Kushtetuta kërkon që gjyqtarët dhe prokurorët të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre. Gjyqtarët emërohen me mandat të përhershëm dhe u ndalohe t'i bashkohen ndonjë aktiviteti ose partie politike. Roli i KGjK-së është që të ruaj pavarësinë e tillë gjyqësore. Vendimi i tij përfundimtar për të emëruar ose shkarkuar një gjyqtar mund të kontestohet nga Presidenti i Kosovës vetëm nëse ka shkelje të procedurës.³¹

Përkundër faktit që Kushtetuta dhe ligjet e parashohin KGjK-në dhe gjyqësorin si të pavarur, në praktikë qëndron pak më ndryshe. Fillimisht një pjesë e anëtarëve të KGjK-së për tu mandatuar duhet të votohen nga Kuvendi, rrjedhimisht mund të konsiderohet një përzjerje e politikës në sistem gjyqësor dhe se grupet e interesit përmes politikës mund të arrijnë të caktojnë përfaqësues të tyre në pozita të larta gjyqësore.³²

Ekziston një brengë që procedura e emërimit është e dobët, dhe perceptimi është që Kuvendi i emëron anëtarët (përfshirë anëtarët jo gjyqësor) në bazë të preferencave politike. Nuk duket të jetë ndonjë procedurë përcaktuar për intervistimin e kandidatëve ose vlerësimin e tyre kundrejt kriterëve të përcaktuara të përzgjedhjes që duket të jenë të kufizuara për të qenë në gjendje që të kontribuohet në menaxhimin dhe funksionimin e gjykatave pa ndonjë përkufizim të mëtejshëm për atë se cilat njohuri, aftësi dhe përvoja kërkohen nga një kandidat.

Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK)

KPK është themeluar me Kushtetutë si një institucion tërësisht i pavarur. Këshilli përbëhet nga 13 anëtarë ku 10 anëtarë janë prokurorë dhe tre anëtarë nuk janë prokurorë, ku njëri është nga Oda e Avokatëve të Kosovës, njëri nga Fakulteti Juridik në Kosovë dhe njëri është përfaqësues nga Shoqëria Civile. Për zgjedhjen e anëtarëve joprokurorë, mbeten ende vakant

³¹Vlerësimi i Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, Instituti Demokratik i Kosovës, tetor 2015 http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/71-kdi-nis-alb_all_single_final.pdf

³²Duke u bazuar në Amandamentimin e Kushtetutës të RKS-së, Nr. 05-V-229, Amandamenti nr. 25, dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht në nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, shtatë (7) anëtarë të KGjK-së janë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit, ndërsa gjashtë (6) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës. Për të qenë anëtar i KGjK-së rregullorja përcakton emërimin e shtatë anëtarëve të gjyqësorit dhe në mënyrë të konsiderueshme përcakton një rregullim më të hollësishëm dhe transparent sesa procesi i miratuar nga Kuvendi. Gjyqtarët duhet të kenë mandat të përhershëm që do të thotë përvojë së paku tre vjeçare që nga emërimi i parë.

pozitat e anëtarëve nga radhët e shoqërisë civile dhe Odës së Avokatëve të Kosovës, përgjegjësi kjo, e cila bie mbi institucionet dhe mekanizmat jashtë Këshillit.

Korniza ligjore është në pajtim me standardet ndërkombëtare pasi që krijon një KPK që është e pavarur nga institucionet tjera shtetërore, pasqyron natyrën multi-etnike të Kosovës, e njeh nevojën për barazi gjinore dhe, së paku në teori, përfshinë prokurorët nga të gjitha nivelet si dhe juristët që nuk janë prokurorë dhe anëtarët e shoqërisë civile.

Ndryshimet në përbërjen e KPK në vitin 2015 në mënyrë të konsiderueshme e kanë ndryshuar baraspeshën në mes anëtarëve prokurorë dhe jo prokurorë nga një proporcion 5:4 në atë 10:3. Kjo është posaçërisht e rëndësishme pasi që për një mori arsyesh ka pasur dështime në rekrutimin e anëtarëve jo prokurorë në KPK për një kohë. Në praktikë kjo krijon një situatë ku KPK nuk ka nevojë për asnjë anëtarë jo prokurorë që të jetë në gjendje ta bëjë punën e tij. Kjo do të thotë që organi përgjegjës për emërimin e prokurorëve, përbëhet në tërësi nga prokurorët dhe, mund ta vazhdojë punën e tij pa pasur nevojë që t'i emërojë anëtarët jo prokurorë.

Anëtarët jo prokurorë emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë “të nivelit të lartë të performancës profesionale, reputacionit moral dhe integritetit personal” të kandidatit. Ekzistojnë kritere shtesë që anëtari i shoqërisë civile duhet t'i përmbush dhe ata gjithashtu duhet të kenë një “kualifikim të lartë profesional në fushën ligjore; njohuri në fushën e të drejtave të njeriut; përvojë pune pesë vjeçare në çështjet ligjore; janë politikisht të pavarur për tre vitet e fundit dhe kanë mbështetjen e së paku pesë organizatave të shoqërisë civile në fushën ligjore”.

Mënyra në të cilën kandidatët jo prokurorë futen në listë të ngushtë për t'u marrë parasysh nga Kuvendi dallon mes tre roleve. Oda e Avokatëve dhe Fakulteti Juridik ftohen nga Kuvendi që ta dorëzojnë listën prej tre kandidatëve. Lidhur me anëtarin e shoqërisë civile, KPK publikon një konkurs i cili përfshinë udhëzimet për dorëzimin e nominimeve dhe realizon vlerësimin preliminar të kandidatëve kundrejt kritereve të përzgjedhjes.

Ligji i Ri për KPK e ndryshon procesin e emërimit të anëtarëve jo prokurorë. Një Komision i Kuvendit (Komisioni për Legjislacion, supozojmë)do të përcaktojë kërkesat për përzgjedhjen e të gjithë anëtarëve jo prokurorë dhe do t'i intervistojë kandidatët për ta vlerësuar përshtatshmërinë e tyre. Një listë e ngushtë prej dy kandidatëve për secilën pozitë do të votohet nga Kuvendi dhe kandidati mund të merr shumicën e votave të tërë Kuvendit (120 anëtarë, 61 vota) madje nëse më pak se gjysma e tërë Kuvendit voton në fakt. Nëse në raundin e parë asnjëri kandidat nuk fiton shumicën e votave, një raund i dytë do të mbahet. Kandidati me numrin më të lartë të votave do të konsiderohet si i zgjedhur. Kjo do të sigurojë emërimin e anëtarëve jo prokurorë duke supozuar që ekziston interes në pozitën në radhë të parë.

Kriteret përshtatshmërisë për tre anëtarët jo prokurorë të KPK janë shumë kufizuese dhe me potencial për diskriminim për sa i përket anëtarit të shoqërisë civile. Kriteret duhet të ndryshohen për të ofruar liri më të madhe veprimi për përfshirjen e kandidatëve të përshtatshëm me përvojë më të madhe, përfshirë ata përtej “fushës ligjore” në mënyrë të ngjashme me qasjen e zbatuar nga KGJK. Të tre anëtarët duhet të obligohen që të jenë politikisht të pavarur për së paku tri vite.

Emërimi i prokurorëve në KPK duhet të bazohet “në nivelin e lartë të performancës profesionale, reputacionit moral dhe integritetit personal”. Anëtarët prokurorë zgjidhen nga mesi i prokurorëve dhe sipas kriterëve shtesë të përzgjedhjes ata nuk duhet të jenë të përfshirë në ndonjë masë disiplinore brenda tre viteve të fundit dhe nuk duhet të jenë të dënuar për vepër penale, përveç kundërvajtjeve, por nuk ka kusht për prokurorin që të ketë një numër të caktuar të viteve të përvojës dhe madje as të kenë mandat të përhershëm. Si rrjedhojë, ka anëtarë të KPK të cilët ende nuk e kanë përfunduar mandatin fillestar prej tre viteve.

Përfshirja e Presidentit në Procesin e Ri-emërimit

Presidenti ka për detyrë që t’i emërojë gjyqtarët me një mandat fillestar dhe ti ri-emërojë ata me një mandat të përhershëm pas propozimit të KGJK-së. Procesit vendim-marrës të Presidentit sikurse përcaktohet me ligj , duket që i mungon një bazë e qartë mbi të cilën Presidenti mund të refuzojë emërimin ose ri-emërimin e një gjyqtari. Ekziston një argument për të sygjeruar që ri-emërimi i jep Presidentit ndikim të tepërt ndaj procesit të emërimit, situatë kjo e cila do të mund të nënkuptonte ndërhyrje në proces. Pavarësisht a është kjo e vërtetë apo jo, situata krijon mundësi për ushtrim të ndikimit të tepruar gjatë procesit të ri-emërimit, ndaj, besimi publik në pavarësinë e procesit do të përmirësohej sikurse ky pushtet nocional i Presidentit në lidhje me ri-emërimin të largohej.

Kornizës Ligjore në të cilën procesi vendimmarrës i Presidentit bazohet, duket që atij i mungon një bazë e qartë në të cilën Presidenti mund të refuzojë mbështetjen e propozimit për emërim të bërë nga KGJK-ja edhe pse Ligji përcakton që nëse bëhet një refuzim i tillë, Presidenti duhet t’i ofrojë arsyet me shkrim për atë refuzim. Kjo ka potencial që të shihet si një mundësi që Presidenti ta nxjerrë vendimin përfundimtar për emërim, në bazë të kriterëve që janë të ndryshme nga ato të “meritës dhe aftësisë” së kandidatit.

Drejtësia përballë Politikës dhe grupeve të interesit

Tash e sa kohë në Kosovë është krijuar perceptimi se njëra ndër arsyet e mungesës së rezultateve në sistemin e drejtësisë, veçanërisht rezultateve në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, është ndikimi i politikës dhe grupeve të interesit.

Fatkeqësisht, ky perceptim nuk shtrihet vetëm në suazat e asaj çfarë mendojnë qytetarët, mirëpo, një gjë e tillë proklamohet edhe nga akterët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile vendore.

Sa i përket kësaj të parës, cilësimet se sistemi kosovar i drejtësisë është i ndikueshëm nga politika janë të vazhdueshme, derisa gjuha e përdorur në të njëjtat raporte nuk është se po zbutet.

Në këtë drejtim, Raportet e progresit për Kosovën për vite me radhë vlerësojnë se ka ndikime në sistemin e drejtësisë në vend.³³ Shqetësues është fakti se edhe Raporti i Progresit për vitin 2020 ndan të njëjtat konstatime. Ky raport vlerëson se *“Gjyqësori është akoma i prekshëm nga ndikimi i papërshtatshëm politik”*.³⁴ Për më tepër lidhur me luftën kundër krimit të organizuar në këtë Raport citohet se *“Nevojiten masa për të siguruar rreptësishtë që nuk ka ndërhyrje politike në aktivitetet operacionale të organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë”*.³⁵

Duhet theksuar se konstatime të tilla nuk derivojnë vetëm nga Raportet e Progresit të BE-së. Me këso lloj të gjeturash kanë dalur edhe të tjerë faktorë të rëndësishëm ndërkombëtar në Kosovë.³⁶

Nga ana tjetër, shoqëria civile kosovare vazhdimisht raporton se si, sipas tyre, sistemi i drejtësisë në vend është i ndikuar dhe i ndikueshëm dhe njëkohësisht vlerësojnë se ka lidhje kauzale mes mungesës së rezultateve në luftën kundër korrupsionit dhe ndikimit të pretenduar të politikës dhe grupeve të interesit në drejtësi.

Kontribuues në perceptimin se sistemi i drejtësisë nuk është faktikisht aq i pavarur, sipas OJQ-ve gjegjëse, janë rastet jo të pakta në numër të identifikuara. Kështu, theksohet se deklarata lidhur me ndikimet politike brenda organeve të drejtësisë kanë ardhur nga vet ish-funksionarë që dikur ishin pjesë e sistemit.³⁷ Apo, edhe fenomeni i mos marrjes së një epilogu lidhur me vendimet e ekzekutivit ku është gjetur se ka konflikt të interesit,³⁸ ndonëse lëndët e pranuar më vonë janë proceduar pa hezitim. E hiq më pak e rëndësishme, është edhe përpjekjet që vijnë nga brenda sistemit të drejtësisë për të amnistuar persona të caktuar të afërt të personave me pushtet.³⁹

³³ Shih: Raportet vjetore të BE-së të Progresit për Kosovën <https://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>.

³⁴ Raporti i BE-së për Kosovën* 2020 {SWD (2020) 356 final}, 6 tetor 2020.

³⁵ Po aty.

³⁶ Shih për shembull: https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/?fbclid=IwY3ABAR3T%3%8B1077j0tpHazEFqf1UKPP0M6ag_akeky96LG65YR%3%8BH2qAy6Orz4PQv4#.XmkyU%3%8BHC_BM.facebook;

³⁷ Vetingu pa Alternativë, IKD dhe Instituti Columbus. dhjetor, 2018 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/01/3.-Vetingu-pa-alternative.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 8 tetor).

³⁸ Shembuj konkret mund të gjenden këtu: <https://betimiperdrejtesi.com/lajme/>.

³⁹ Shih për shembull: *“Vetingu pa alternativë”*.

Po ashtu, krahas mungesës së rezultateve në luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë, shoqëria civile ka dokumentuar vazhdimisht probleme edhe në trajtimin e rasteve të profileve të tjera të korrupsionit në përgjithësi, veçanërisht, probleme sa i përket dënimeve të shqiptuara.⁴⁰

Shtuar kësaj, sipas shoqërisë civile që monitorojnë nga afër punën e organeve të sistemit të drejtësisë, kontaktet e papërshtatshme të evidentuara të politikanëve me funksionarë të ndryshëm të sistemit kosovar të drejtësisë, zbehin edhe më tej idenë e pavarësisë së plotë të sistemit të drejtësisë.

Të gjitha këto raportime nga vendorët dhe ndërkombëtarët, bëjnë të vihet në pikëpyetje nëse në sistemin e drejtësisë shtrihet ndikimi i politikës dhe grupeve të interesit. Kjo pa dashur të dilet në përfundim se e tërë drejtësia në vend është e ndikuar nga jashtë.

Mirëpo, sado të izoluara qofshin këto raste, ato duhet analizuar dhe adresuar, fillimisht për të lehtësuar rrugën e Kosovës drejtë BE-së, e po ashtu për të siguruar, çka është më e rëndësishmja, se parimi kushtetues i pavarësisë së gjyqësorit dhe prokurorisë po zbatohet.

3.1.2 Çështja e emërimit dhe riemërimit/rekrutimit

Procesi i riemërimit

Për procesin e emërimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve është shkruar dhe shtjelluar më sipër, ndërsa këtu do të trajtohet vetëm si një sfidë shtesë për sistemin e drejtësisë.

Para ndryshimeve ligjore të vitit 2015, prokurorët e sapoemëruar kanë filluar të trajtojnë menjëherë lëndë.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2015 në Ligjin për Prokurorin e Shtetit është përcaktuar se prokurorët e sapoemëruar do të mbajnë trajnim fillestar për 12 muaj në akademinë e drejtësisë, ndërsa 2 vitet tjera do të trajtojnë lëndë në Departamentin e Përgjithshëm të prokurorive themelore.

Prokurorët të cilët e kalojnë me sukses mandatin fillestar 3 vjeçar riemërohen me mandat të përhershëm. Këtij procesi i paraprijnë 2 procese të vlerësimit të performancës, fillimisht pas përfundimit të trajnimit 1 vjeçar në Akademinë e Drejtësisë dhe një proces i vlerësimit në fund të mandatit 3 vjeçar.

Në anën tjetër Këshilli Gjyqësor i Kosovës poashtu gjatë tërë kohës, në periudha të ndryshme, ka qenë në proces të emërimit dhe rekrutimit të gjykatësve në kuadër të plotësimit të pozitave të nevojshme edhe me organogram. Edhe gjyqtarët si prokurorët kalojnë nëpër

⁴⁰ Për ilustrim, IKD nga monitorimet e tyre thekson rastin ku një person që kishte blerë objekt të vjedhur të vlerës së vogël ishte dënuar aq sa ishte dënuar një person për kryerje të korrupsionit, dëmi në të cilin rast ishte me dhjetëra mijëra euro.

procesin e riemrimit pas kalimit të periudhës së paraparë me dispozita ligjore. Konflikti i interesit në sistemin e drejtësisë

Njëra ndër sfidat e sistemit kosovar të drejtësisë është edhe konflikti i interesit brenda këtij sistemi. Lidhur me konfliktin e interesit brenda sistemit të drejtësisë ka pasur vazhdimisht raportime, por se kjo fushë në sistemin e drejtësisë është paraqitur në njëfarë forme si fushë në të cilën nuk ka vullnet për tu rregulluar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës gjatë vitit 2015 është përcjellë me shumë polemika dhe paqartësi lidhur me zgjatjen e mandatit ligjor të disa anëtarëve KPK-së, respektivisht mandatin e nga PSRK, nga Prokuroritë Themelore. Edhe përkundër faktit se ligji kishte përcaktuar se mandati i anëtarit të KPK-së është pesë vjeçar pa mundësi vazhdimi, KPK gjatë vitit 2015, kishte vendosur që edhe përkundër kësaj të vazhdoj mandatin e dy anëtarëve të KPK-së. Të dy anëtarët kishin marr pjesë në diskutim dhe kishin votuar lidhur me zgjatjen e mandatit të tyre. Votimin për zgjatjen e mandatit për vete, i cili krijon fuqi në mundësinë e vendimmarrjes për politikën e sistemit prokurorial, përfshi edhe beneficionet tjera të të qenit anëtar i KPK-së paraqiste situatë të konfliktit të interesit. Aso kohe, partnerët ndërkombëtar si Ambasada Amerikane dhe projekti i Bashkimit Evropian që e mbështesnin KPK-në kanë dhënë opinione me shkrim se pjesëmarrja në diskutim dhe votimi për vetën bie në kundërshtim me ligjin. EULEX-i kishte pasur qëndrim të kundërt.

Ligji i ri ka adresuar drejtë shumë fusha, ku ndër to janë edhe ndalimi i mbajtjes së më shumë se një (1) pozite, përjashtimisht rasteve kur kjo kërkohet me ligj, dhe ndalimit të zyrtarit të lartë që të zgjedhet në pozita udhëheqëse dy (2) vite pasi të përfundojë mandatin.

Përkundër përcaktimeve të qarta ligjore për këto situata, pikërisht këto dy (2) situata të konfliktit të interesit kanë qenë të shprehura vazhdimisht në sistemin kosovar të drejtësisë.

Sa i përket mbajtjes së më shumë se një (1) pozite, kjo dukuri ka qenë vazhdimisht e shprehur, ku ka pasur raste kur një zyrtar ka mbajtur më shumë pozita udhëheqëse, se sa të përcaktuara me ligj.

Ndërsa, edhe situata e dytë e konfliktit të interesit ka qenë vazhdimisht e shprehur, sa që tanimë pothuajse është krijuar dukuri, që në pozitat udhëheqëse të prokurorive dhe gjykatave, të zgjidhen ish anëtarët e këshillave. Kjo kishte ndodhur kështu me Kryeprokurorin aktual të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, i cili paraprakisht kishte dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për t'i hyrë kësaj gare, si dhe me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Pejë, i cili kishte vepruar po në të njëjtën mënyrë.⁴¹

⁴¹ Shih "Këshilla për Këshillat". IKD. Prill 2020. F.60-62; "Ligji ndalon "fluturimin e supermenëve" me shumë pozita drejtuese dhe ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë nga shtesat". IKD. Maj 2018.

Shpërfaqjeje e kësaj problematike ishte edhe rasti i fundit me dorëheqjen e 3 anëtarëve të KPK-së pak para se KPK ta hap konkursin për kryeprokurorë, dy prej të cilëve pas reagimeve të shumta, kishin revokuar dorëheqjet.

3.2 Llogaridhënia

3.2.1 Menaxhimi i lëndëve – parashkrimi

Një ndër problemet dhe sfidat e vazhdueshme në sistemin e drejtësisë, ka qenë edhe menaxhimi i lëndëve, me theks të veçante në gjykata. Republika e Kosovës, për një kohë të gjatë është ballafaquar me numër të madh të lëndëve të pazgjidhura, të cilat janë shtuar nga viti në vit. Formimi i profesioneve të lira, me këtë rast edhe përmbarimi privat, pastaj rritja graduale e numrit të gjykatësve, ka filluar të lehtësojë punën e gjykatave me numrin e lëndëve.

Sidoqoftë numri i madh i lëndëve, ka vazhduar të ketë pasojat e saj në sistemin e drejtësisë. Një ndër pasojat me të theksuara, është parashkrimi i lëndëve në gjykata. Sistemi gjyqësor ballafaqohet me problemin e parashkrimit të lëndëve që nga paslufta (viti 2000). Derisa në njërin anë numri i lëndëve të parashkruara vazhdon të jetë i madh, në anën tjetër nuk kemi ndonjë masë apo llogaridhënie ndaj përgjegjësve të parashkrimit në rastet kur parashkrimi ka ndodhur me fajin e tyre. Parashkrimi si institut i së drejtës, pamundëson ndjekjen penale si dhe ekzekutimin e sanksionit penal ndaj kryeseve, pas kalimit të afatit të përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Parashkrimi si dukuri prezente në sistemin e drejtësisë në Kosovë, kishte shoqëruar si sistemin prokurorial, poashtu edhe atë gjyqësor.

Të dhënat në tabelën si më poshtë, pasqyrojnë numrin e lëndëve të parashkruara në sistemin prokurorial, të cilat janë siguruar nga KPK.

Ngarkesa e prokurorive me lëndë dhe efikasitetit në zgjidhjen e tyre ndër vite													
		Raste të pranuar				Raste të zgjidhura				Numri i prokurorëve			Pushimi i procedurës për shkak të parashkrimit
		PP	PPM	PPN	Totali	PP *	PPM	PPN	Totali		Ngarkesa e prokurorëve me lende	Lendet e zgjidhura për prokuror	
1	2013	26397	1730	20396	48523	21446	1426	11358	34230	123	394.50	278.29	55
2	2014	27556	1751	8261	37568	21568	1581	5693	28842	139	270.27	207.50	175*
3	2015	25412	1795	9810	37017	25183	1689	7878	34750	149	248.44	233.22	8
4	2016	25227	1857	10652	37736	28465	2215	7978	38658	171	220.68	226.07	8
5	2017	24912	2073	12369	39354	33510	2821	12002	48333	177	222.34	273.07	3
6	2018	27484	2540	11987	42011	30478	2746	17027	50251	191	219.95	263.09	10
7	2019	24540	2027	10321	36888	26479	2141	15603	44223	197	187.25	224.48	10
Gjashtëmu jori 2020		9375	640	3272	13287	9048	496	4661	14205	191	69.57	74.37	18

Sipas KPK-së, numri i lartë i parashkrimeve gjatë vitit 2014 e cila është shifër më e theksuar, ka ndodhur për shkak të ndryshimeve ligjore në Kodin Penal dhe në strukturën organizative të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Tutje numër i theksuar i rasteve të parashkruara ndodhet në sistemin gjyqësor me ç'rast përveç rasteve të parashkruara, ekzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm i rasteve që rrezikojnë të parashkruhen.

Gjykatat e Kosovës deri në fund të vitit 2020 ka rrezik të parashkruhen 492 lëndë prej tyre i përkasin parashkrimit absolut 443 dhe 49 parashkrimit relativ.⁴²

Të dhënat janë siguruar vetëm për gjykatat themelore Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan dhe Pejë. Kurse për Gjykatat Themelore të Prishtinës, Prizrenit dhe Mitrovicës të dhënat nuk kanë mundur të sigurohen.

⁴²"Qindra lëndë mund të parashkruhen deri në fund të vitit", Preportr, korrik 2020 - http://preportr.cohu.org/repository/docs/09_-_Preportr_-_No_35_-_Parashkrimi_-_04_466857.pdf.

Gjykata	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ	Gjithsej
Ferizaj	232	X	232
Gjakovë	45	X	45
Gjilan	140	26	166
Pejë	49	X	49

Bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2019, në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar 25,909 lëndë penale.

Parashkrimi i lëndëve në gjykata në periudhën 2000 - 2019										
Gjykata/Viti	2000/2010	2011/12	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Totali
GjTh Prishtinë	276	242	105	163	221	968	1,176	1,471	1,259	5,881
Lipjan	17	67	0	2	3	3	18	23	45	178
Podujevë	0	0	485	332	344	280	230	208	133	2,012
Drenas	4	0	2	8	1	6	2	1	-	24
Graçanicë	-	-	-	-	-	-	-	0	0	0
GjTh Prizren	1,536	15	709	295	122	149	214	284	130	3,454
Suharekë	78	101	57	107	56	36	65	35	39	574
Drtagash	2	17	11	6	23	12	21	23	13	115
GjTh Pejë	435	13	27	15	10	7	3	12	0	522
Klinë	299	224	63	12	149	64	20	22	11	864
Istog	242	307	172	45	77	37	18	9	0	907
Deçan	514	27	5	17	56	33	1	8	19	680
GjTh Gjilan	0	0	136	116	157	113	177	85	117	901
Kamenicë	140	77	41	33	16	13	43	25	25	413
Viti	0	0	90	48	34	65	80	46	15	378
Novobërdë	0	0	20	7	6	2	8	2	0	45
GjTh Ferizaj	870	369	53	249	374	354	260	237	266	3,032
Kaçanik	93	166	88	52	53	55	64	87	17	675

Shtërpecë	3	15	6	9	7	3	22	18	10	93
GjTh Gjakovë	461	120	15	34	44	26	34	27	29	790
Rahovec	1,049	0	65	160	38	107	70	44	35	1,568
Malishevë	214	79	44	53	49	37	60	39	48	623
GjTh Mitrovicë	0	0	19	270	185	752	246	123	105	1,700
Vushtrri	151	24	10	9	16	8	1	25	20	264
Skenderaj	13	14	7	10	4	8	12	42	13	123
Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-	28	62	90
Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	0	3	3
Total	6,397	1,877	2,230	2,052	2,045	3,138	2,845	2,923	2,414	25,909

Gjatë kësaj periudhe janë parashkruar edhe lëndët që lidhen me korrupsionin. Në mesin e lëndëve të cilat janë vjetërsuar ka edhe lëndë që i përkasin Kapitullit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK): “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”, lëndë këto të cilat organet përkatëse kanë pasur për detyrë t’i trajtojnë me prioritet. Vetëm gjatë viteve 2013-2018 në gjykatat e Republikës së Kosovës janë parashkruar 58 lëndë të kësaj natyre prej tyre 8 në aspektin relativ ndërsa 50 në aspektin absolut.⁴³

Deri më tani institucionet e vendit nuk kanë ndërmarr asnjë masë për parandalimin apo luftimin e trendit të parashkrimit të lëndëve. Sidoqoftë i vetmi ndryshim që është bërë pas plotësimit dhe ndryshimit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, është zgjatja e afateve ligjore të parashkrimit.

Duke u bazuar në të dhënat e KGjK-së dhe KPK-së si dhe hulumtimeve të organizatave të shoqërisë civile nuk është identifikuar ndonjë ndëshkim i gjykatësve dhe prokurorëve si pasojë e neglizhencës të tyre dhe numrit të madh të rasteve të parashkruara. Deri më sot nuk ka pasur asnjë rast që një gjykatës ose prokuror të jetë shkarkuar për shkak se ka lejuar vjetërsimin e lëndës.

Përgjithësisht, janë dy (2) lloj shkaqesh që ndikojnë në parashkrimin e numrit të lëndëve në sistemin e drejtësisë: Objektive dhe subjektive.

Sa i përket shkaqeve objektive, fillimisht duhet vënë theksin tek numri i madh i lëndëve, të cilat janë akumuluar në sistemin e drejtësisë ndër vite. Në kuptim të numrit të madh të

⁴³Qasja në drejtësi - Raport i monitorimit në gjykatat themelore në Republikën e Kosovës për periudhën tetor 2018 – shtator 2019; Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet “ÇOHU”, nëntor 2019 Prishtinë - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-218>.

lëndëve, sistemi i drejtësisë ka një progres, por se ky progres nuk është i nivelit që do të mund të garantonte shqyrtim të lëndëve brenda afateve kohore, rrjedhimisht edhe mos parashkrim të rasteve. Ndërsa, si rrethanë tjetër objektive paraqitet edhe numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve në raport me ngarkesën me lëndë. Paraqiten edhe rrethana të tjera objektive që ndërlidhen me specifikat e rasteve të caktuara, por se këto rrethana nuk kanë një karakter të përgjithshëm.

Në anën tjetër, edhe rrethanat subjektive janë shkaktarë të parashkrimit të rasteve. Mos trajtimi i lëndëve sipas prioriteteve, mungesa e efikasitetit tek disa gjyqtarë dhe prokurorë e në disa raste të veçanta edhe trajtimi selektiv i rasteve janë faktorë që ndikojnë në parashkrimin e rasteve. Edhe brenda për brenda kategorisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët e arrijnë normën orientuese të përcaktuara nga KGJK, respektivisht KPK, ka diferenca në numrin e lëndëve të kryera nga një gjyqtar apo prokuror. Kjo pasi përballë faktit se ka gjyqtarë dhe prokurorë të cilët e tejkalojnë dyfishin apo trefishin e normës orientuese, ka të tjerë që zgjidhin lëndë në minimumin e normës orientuese.

3.2.2 Mungesa e performancës (performanca profesionale): Mos përgatitja e prokurorëve dhe performanca e gjykatësve

Sipas shoqërisë civile, sistemi i drejtësisë në Kosovë, gjykatat dhe prokuroritë, vazhdojnë të ballafaqohen me mungesë faktike performancës së prokurorëve dhe gjykatësve gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre.

Përfaqësimi i aktakuzave nga ana e prokurorisë vazhdon të përcillet me probleme të shumta pothuajse në të gjitha gjykatat themelore sipas gjetjeve të Organizatave jo qeveritare dhe vet ankesave të avokatëve.

Disa nga problemet kryesore të cilat ndërlidhen me përfaqësimin e aktakuzave, të identifikuar nga organizatat e shoqërisë civile të cilat monitorojnë sistemin e drejtësisë, janë: pa përgatitja e prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave, ndërrimi i vazhdueshëm i prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave si dhe numri i pamjaftueshëm i tyre në raport me numrin e lëndëve, përkundër rritjes së numrit të prokurorëve. Të gjitha këto probleme, vazhdojnë të pamundësojnë përfaqësimin e denjë dhe profesional të aktakuzave të prokurorëve gjatë zhvillimit të shqyrtimeve gjyqësore.⁴⁴

⁴⁴Qasja në drejtësi dhe të drejtat e njeriut - Raport i monitorimit në gjykatat themelore në Republikën e Kosovës për periudhën maj 2016 – maj 2017; Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet “ÇOHU”, korrik 2017 Prishtinë - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-dhe-te-drejtat-e-njeriut-202>;

Qasja në drejtësi - Raport i monitorimit në gjykatat themelore në Republikën e Kosovës për periudhën tetor 2018 – shtator 2019; Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet “ÇOHU”, nëntor 2019 Prishtinë - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-218>.

Sipas dispozitave ligjore dhe etike, Prokurori i Shtetit gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të jetë profesional, të zbatojë standarde të larta të punës, të jetë i pavarur, efikas dhe detyrën e tij duhet ta ushtrojë me dinjitet e përgjegjësi.⁴⁵

Andaj mos përgatitja e prokurorëve për përfaqësimin e aktakuzave dhe argumentimin e pretendimeve të tyre të paraqitura në po këto akte akuzuese, bie ndesh me dispozitat ligjore dhe etike, ato të KPRK-së, Ligjit për Prokurorin e Shtetit si dhe Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve.⁴⁶

OJQ-të kanë identifikuar raste të mos përgatitjes së prokurorëve dhe të ndërrimit të tyre të vazhdueshëm të cilat kishin pasur pasojat në mbarëvajtjen e gjykimeve dhe gjithashtu në zvarritjen e rasteve.⁴⁷

Ndërrimi i prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave është problem tjetër që vazhdon t'i kontribuojë mungesës profesionale dhe përfaqësimit të dobët të prokurorisë në argumentimin dhe mbështetjen e akuzave.

Raste të ndërrimit të prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave janë identifikuar pothuajse në të gjitha gjykatat themelore. Madje, duke u bazuar në monitorim, kemi raste kur në përfaqësimin e një aktakuze janë ndërruar tre prokurorë të ndryshëm.⁴⁸

Ndërrimi i prokurorëve kishte ndodhur për arsye të ndryshme disa nga arsyet kishin qenë për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, arsye të tjera kishin të bënin edhe me lëvizjen e prokurorëve në nivelet e tjera, ndërsa disa të tjera edhe për shkak të pensionimit të tyre.

Pa përgatitja e prokurorëve për përfaqësimin e aktakuzave, mangësitë profesionale si dhe përfaqësimi i dobët i prokurorisë për arsyet e ndryshme, ka vazhduar t'i kushtojë sistemit të drejtësisë me mungesë efikasiteti dhe rezultate të dobëta në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

KPK dhe KGJK kanë pasur vazhdimisht mekanizmat e kontrollit të brendshëm që zhvillojnë procesin e disiplinimit dhe vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga viti 2013 e deri në fillim të vitit 2019, sistemi i disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është zhvilluar nëpërmjet Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Përkundër faktit se masa disiplinore evidentoheshin vazhdimisht, gjatë kësaj periudhe kohore nuk ishte shkarkuar/degraduar asnjë prokuror apo gjyqtar. Përgjithësisht, ishte konsideruar se kjo zyrë nuk e ka arritur qëllimin për të cilin është themeluar.

⁴⁵Ligji për Prokurorin e Shtetit, me ndryshimet pasuese: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>; Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë - <http://www.kpk-rks.org//sistemi/121/kodi-i-etiks-profesionale-/121>;

⁴⁶Po aty.

⁴⁷Shih për shembull rastin PKR. nr. 168/16.

⁴⁸ Për shembull në lëndën me numër PKR. 371/17.

Në fillim të vitit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas të cilit ligj, shuhet ZPD dhe disiplinimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve kthehet tërësisht brenda sistemit të drejtësisë.

Sipas këtij ligji, KPK ka shqiptuar masat disiplinore si në vijim:

- 4 vendime “Nuk ka kryer shkelje”;
- 1 Transferim i përhershëm nga pozita e prokurorit të Departamentit të Krimeve të Rënda, në Departament të Përgjithshëm;
- 5 vërejtje jo publike me shkrim;
- 2 zvogëlim i përkohshëm i pagës për 30% për një periudhë 6 mujore;
- 1 zvogëlim i përkohshëm i pagës për 50% për një periudhë 1 vjeçare (me vendim të Gjykatës Supreme është ndryshuar në: Zvogëlim i përkohshëm i pagës 50% për 6 muaj).

Por, përkundër ngritjes së numrit të masave disiplinore të shqiptuara nga KPK, shoqëria civile kishte monitoruar zbatimin e këtij ligji nga afër. Gjetjet e shoqërisë civile konstatonin se miratimi i ligjit të ri nuk bënë kthesën në sistemin e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga ky monitorim, shoqëria civile theksonte se brenda sistemit të drejtësisë evidentohet mungesë e vullnetit për ngritje të llogaridhënies përmes disiplinimit, trajtim jo profesional i ankesave disiplinore dhe qasje selektive, derisa kishte edhe probleme të vogla ligjore. Progresi i evidentuar, sipas shoqërisë civile ishte minimal⁴⁹.

Në anën tjetër, Raporti i Progresit për vitin 2020 theksonte se “Megjithëse ka pasur njëfarë progresi në zbatimin e kornizës ligjore për masat disiplinore, akoma duhen përpjekje për të siguruar zbatim më të qëndrueshëm dhe më efektiv të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Sa i përket gjykatësve, performancë e patheksuar vazhdon të mbetet të rastet me të ndejshme, në veçanti të ato të Korrupsionit dhe të Korrupsionit të nivelit të lartë. Përveç kritikave të vazhdueshme të organizatave vendore të cilat monitorojnë sistemin e drejtësisë, gjithashtu organizata dhe institucione ndërkombëtare, vazhdojnë të kritikojnë gjyqësorin për mos efikasitet në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe gjithashtu në apelimet e vazhdueshme të vendimeve. Sipas raportit të departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2019, edhe pse ekziston baza ligjore për ndjekjen dhe ndëshkimin për rastet e korrupsionit, problemi mbetet të mungesa e zbatimit të ligjit. Në raport theksohet se mungesa e një mbikëqyrje efektive gjyqësore si dhe problemet tjera me sundimin e ligjit, vazhdojnë t'i kontribuojnë në përgjithësi kësaj problematike, duke theksuar kështu faktin e apelimit të vazhdueshëm të rasteve të korrupsionit në instancat më të larta të gjykatave dhe gjithashtu parashkrimin e rasteve.⁵⁰

⁴⁹ “Llogaridhënia e Gjykatësve dhe Prokurorëve”. IKD. Tetor. 2020.

⁵⁰Seksioni IV – Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri - Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për vitin 2019 – Kosova; Mars 2020; <https://state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights->

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019, thekson problemet me sundim të ligjit në Kosovë, ndërsa sa i përket funksionimit të gjyqësorit, tutje raporti identifikon se Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një sistemi funksional gjyqësor, duke theksuar pak progres të arritur në vitin 2018.⁵¹

Në anën tjetër, duke iu referuar komenteve të pranuar nga ana e avokatëve, vështirësive dhe problemeve që ata hasin në praktikë në ushtrimin e profesionit të avokatit dhe të cilat ndërlidhen me performancën e prokurorisë dhe gjykatave, disa çështje i faturohen edhe mungesave profesionale dhe asaj teknike të akterëve të sistemit të drejtësisë, që në rastin konkret kemi të bëjmë me gjyqtarë dhe prokurorë.

Sipas Odës së Avokatëve, mohimi i të drejtës së të pandehurit për t'u informuar në gjuhën që e flet, Vonesat dhe mungesat nga prokurorët dhe gjyqtarët në seanca, Mos dorëzimi i shkresave të lëndës me kohë, Mosrespektimi i afateve procedurale, Zgjatja e hetimeve në afat të pa arsyeshëm, Refuzimi për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në shumë raste, Caktimi i masës së paraburgimit duke mos aplikuar masat tjera me te buta, Mos realizimi i audio-incizimit të seancave gjyqësore, Mos dërgimi i ftesave me rregull nga gjykata dhe prokuroria, Sjellja me vonesë nga qendra e paraburgimit, Shtyrjet e panevojshme të seancave gjyqësore, Mungesa e arsytimit të duhur dhe të mjaftueshëm të pretendimeve të palëve, Mos argumentimi i pretendimeve nga ana e gjykatës lidhur me kërkesën për hudhjen e Aktakuzës, Mos argumentimi nga ana e gjykatës të i pretendimeve ankimore kundër caktimit të masës së pranisë së të pandehurit në procedure, Mos argumentimi i pretendimeve dhe refuzimi i propozimeve që jepen gjatë shqyrtimit gjyqësor, Mos argumentimi i refuzimit të pretendimeve ankimore kundër aktgjykimeve, Mos argumentimi i pretendimeve nga ushtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme, Refuzimi dhe mos argumentimi i pretendimeve për caktimin e masës së të përkohshme dhe të sigurisë në procedurën kontestimore dhe atë të Konfliktit Administrativ, Mungesa e arsytimit në vendime gjyqësore, me theks të veçantë mungesa e arsytimit të refuzimit të pretendimeve për pafajësinë në rastet penale dhe Mungesa e arsytimit në procedurën kontestimore të pretendimeve të palës kundërshtare etj.⁵²

3.2.3 Shkeljet e afateve ligjore-procedurale

Afatet procedurale ligjore, shpesh kanë qenë objekt i shkeljes në procedurat hetimore dhe gjyqësore gjatë trajtimit të rasteve të natyrave të ndryshme nga prokuroritë dhe gjykatat.

practices/kosovo/?fbclid=IwAR3TÈ1077j0tpHazEFqf1UKPP0M6ag_akeky96LG65YRÈH2qAy6Qrz4PQv4#.XmkyUWHC_B.M.facebook

⁵¹Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019, Bruksel, 29.5.2019 https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/COUNTRY_19_2776.

⁵²Behar Ejupi – Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës, shtator 2020, Prishtinë.

Ky dokument, trajton shkeljet e afateve procedurale ligjore gjatë zhvillimit të një procedure hetimore dhe gjyqësore, në prokurori dhe gjykata.

Shkelja e afateve ligjore në procedurat hetimore, ishte përcjellur me pasojat e nxjerrjes së vendimeve për parashkrim nga ana e prokurorisë për shkak të mos-respektimit të afatit të trajtimit të rasteve.

Organizata të shoqërisë civile, kanë identifikuar raste të parashkrimit të ndjekjes penale nëpër prokurori dhe raste të mos-respektimit të dispozitave procedurale ligjore që kanë të bëjnë me afatin e vendosjes për lëndët e pranuar në prokurori.⁵³

Monitoruesit e organizatave të shoqërisë civile, kishin identifikuar raste të korrupsionit të parashkrimit të ndjekjes penale, në të cilat PSRK dhe PTh-të, kanë nxjerrë vendime për hudhje të kallëzimeve penale dhe vendime për pushim të hetimeve për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Bazuar në publikimet e OJQ-vë të cilat monitorojnë sistemin e Drejtësisë, vetëm në periudhën 4 nëntor 2013 – 31 dhjetor 2014, ishin identifikuar gjithsej 54 lëndë të parashkrimit në PSRK dhe prokuroritë themelore, të cilat kishin hudhur poshtë kallëzimet penale dhe kishin pushuar hetimet për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.⁵⁴

Sa i përket shkeljeve të afateve ligjore procedurale në procedura hetimore, janë identifikuar raste të mos-respektimit të afateve ligjore të përcaktuara me dispozita ligjore, përkatësisht me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Në nenin 82 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet afati 30 ditor me rastin e hudhjes poshtë të kallëzimeve penale. Për periudhën

⁵³ Qasja në drejtësi - Raport i monitorimit në gjykatat themelore në Republikën e Kosovës për periudhën tetor 2018 – shtator 2019; Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet “ÇOHU”, nëntor 2019 Prishtinë - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Oasja-ne-drejtisi-218>.; “Pandëshkueshmëria e Korrupsionit, rrezik për shoqërinë dhe shtetin”. IKD. Mars 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/1-Tri-vjet-kunder-korrupsionit-IKD-versioni-SHQJP.pdf>); “Krimet e rënda në Kosovë, ligji vs. praktika”. IKD. Shtator 2019. (Shih linkun https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Raporti-p%C3%ABr-Krimet-e-R%C3%ABnda_21.09.201-FINAL-1-1.pdf); “Amnistia e ligjshme e milionave të kundërvajtjeve”. IKD. Nëntor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Amnistia-e-ligjshme-e-milionave-te-kundervajtjes-IKD-09.11.2019-3.pdf>); “Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs. praktika”. IKD. Nëntor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Krimet-e-P%C3%ABrgjithshme-ne-Kosove-ligji-vs-praktika-10.11.2019-ME-BALLINE-1.pdf>); “Dështimet Speciale në luftimin e korrupsionit”. IKD. Nëntor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Deshtimet-speciale-ne-luftimin-e-korrupsionit-18.11.2019-ALB.pdf>); “Kosova (s)ka korrupsion të profilit të lartë”. Dhjetor 2019. IKD. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/Kosova-ska-korrupsion-te-proflit-te-larte-FINAL.pdf>); “Lufta për statistika të korrupsionit”. Qershor 2020. IKD. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/06/1-RAPORTI-VJETOR-I-KORRUPSIONIT-2019-IKD-1.pdf>); “Krimet e Rënda – 2019”. Nëntor 2020. IKD. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD-Krimet-e-Renda-2019-1.pdf>).

“Krimet e përgjithshme 2019”. Nëntor 2020. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/Krimet-e-p%C3%ABrgjithshme-Final.pdf>).

⁵⁴Korrupsioni në Kosovë, 4 dhe 5, publikuar në vitet 2014 dhe 2015; <https://kli-ks.org/korrupsioni-ne-kosove-4-raport-vleresues-periodik-mbi-efikasitetin-e-sistemit-prokurorial-ne-zbatimin-e-planit-te-veprimit-per-rastet-e-korrupsionit/>;

e njëjtë 4 nëntor 2013 – 31 dhjetor 2014, janë identifikuar gjithsej 41 raste të tilla të shkeljes së këtij afati ligjor në të gjitha PTh-të dhe në PSRK.⁵⁵

Shkelje të tilla të afateve kanë ndodhur edhe në procedurat në gjykatë, nga momenti i pranimit të aktakuzës në gjykatë, shqyrtimit fillestar, atij dytësor dhe kryesor si dhe shkelje të afateve të përfundimit të një shqyrtimi gjyqësor.

Zhvillimi i procesit gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme është parim themelor juridik, i cili është i paraparë edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Neni 6 i kësaj Konvente thotë: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj...”*⁵⁶. Gjithashtu dispozitat e Republikës së Kosovës parashohin gjykimin brenda afateve të arsyeshme.

Vlen të theksohet fakti se me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i cili kishte hyrë në fuqi në vitin 2013, janë paraparë afatet kohore brenda të cilave duhet të mbahen seancat gjyqësore. Nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, procedimi dhe shqyrtimi i rastit është kategorizuar në shqyrtimin e parë apo fillestar, atë dytësor kur gjykata konsideron të nevojshëm si dhe në shqyrtimin kryesor.

Në nenin 242 të Kodit të Procedurës Penale është paraparë afati i trajtimit të rasteve të tilla nga momenti i pranimit të rasteve në gjykatë. Paragrafi 4 i këtij neni parasheh caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar gjyqësor brenda 30 ditësh nga momenti i ngritjes së aktakuzës, ndërsa paragrafi 5 parasheh afatin 15-ditor të caktimit dhe mbajtjes së shqyrtimit fillestar prej ngritjes së aktakuzës në rastet me paraburgim.⁵⁷

Afatet janë paraparë gjithashtu për shqyrtimin dytësor dhe atë kryesor si dhe për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Derisa mbajtja e shqyrtimit dytësor është paraparë jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se katërdhjetë (40) ditë pas shqyrtimit fillestar, shqyrtimi kryesor është paraparë të mbahet brenda një muaji nga shqyrtimi dytësor. Përkundër faktit se Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parasheh afate të rrepta sa i përket caktimit të seancave gjyqësore, organizatat monitoruese të shoqërisë civile kanë identifikuar shtyrje dhe shkelje të afateve në caktimin dhe shqyrtimin e rasteve nga monitorimi i rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar.⁵⁸

Madje në disa raste të trajtuara nga gjykata vonesat shkojnë deri në rreth 1500 ditë, vetëm në shkallë të parë. Kjo normalisht është në kundërshtim me vet Kodin e Procedurës dhe konventat ndërkombëtare. Zgjatja e një procesi gjyqësor ndodh edhe në procedurën civile

⁵⁵Po aty.

⁵⁶Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6: https://echr.coe.int/Documents/Convention_SOI.pdf

⁵⁷Kodi i Procedurës Penale, neni 242 par.4 dhe par.5.

⁵⁸Qasja në drejtësi - Raport i monitorimit në gjykatat themelore në Republikën e Kosovës për periudhën tetor 2018 – shtator 2019; Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet “ÇOHU”, nëntor 2019 Prishtinë - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-218>.

madje problematike shihet edhe në vendimet e shkallëve gjyqësore. Ndonëse kjo dukuri mund të vie si pasojë e faktorëve si për shembull numri jo i mjaftueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të lihet anash çështja nëse këto dukuri po paraqiten për shkak të mungesës së performancës apo integritet profesional⁵⁹.

3.2.4 Mekanizmat e performancës së KPK dhe KGjK

Procedura e vlerësimit të performancës së prokurorëve është e rregulluar me Ligj⁶⁰ dhe Rregullore.⁶¹ Vlerësimi bëhet nga Komisioni i përhershëm i Këshillit për vlerësim të performancës së prokurorëve, i cili ka në përbërje 3 prokurorë.

Vlerësimi i performancës së prokurorëve, me mandat fillestar, bëhet së paku dy (2) herë gjatë këtij mandati nga Komisioni për vlerësim të performancës së prokurorëve, një (1) herë pas trajnimit fillestar dhe një (1) herë në fund të mandatit fillestar.⁶²

Vlerësimi i performancës së prokurorëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tre (3) vjet, në mënyrën e tillë që, Këshilli cakton me short një e treta (1/3) e prokurorëve, brenda secilës prokurori, si grupin e parë të cilët do t'u nënshtrohen vlerësimit të performancës në afat prej tre (3) muajsh. I njëjti short mbahet pas një (1) viti për të caktuar prokurorët që do bëjnë pjesë në grupin e dytë dhe grupin e tretë pas dy (2) viteve, respektivisht.

Sipas përfaqësuesve të KPK-së, që nga themelimi i Komisionit e deri më sot (01 janar 2014 deri më 21 shtator 2020) është realizuar vlerësimi i performancës për 374 prokurorë, që sipas nivelit të vlerësimit janë si në vijim:

- 194 shumë mirë,
- 171 Mirë,
- 7 mjaftueshëm (të cilët sipas Rregullores obligohen të vijnë trajnimin e detyrueshëm)
- 2 Mjaftueshëm (në kuadër të vlerësimit të jashtëzakonshëm)⁶³

⁵⁹ "Drejtësia Civile në Kosovë: Ligji vs. Praktika". Nëntor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-Ligji-vs.-Praktika-03.11.2019-1.pdf>); "Drejtësia civile – 2019". IKD. Nëntor 2020. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-2019-2.pdf>); "Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs. praktika". IKD. Nëntor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Krimet-e-P%C3%ABrgjithshme-ne-Kosove-ligji-vs-praktika-10.11.2019-ME-BALLINE-1.pdf>); "Krimet e përgjithshme 2019". Nëntor 2020. (Shih linkun https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/Krimet-e-p%C3%ABrgjithshme_Final.pdf).

⁶⁰Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës - <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Legjislacioni/LIGJI%20NR.%2006%20L-056%20P%C3%8BR%20K%C3%8BSHILLIN%20PROKURORIL%20T%C3%8B%20KOSOV%C3%8BS.pdf>.

⁶¹Rregullore Nr 12/2015 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve - <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/AkteNenLigjore/Nr.1460.2015-Rregullore%20Nr.12.2015-Per%20vleresimin%20e%20performances%20se%20prokuroreve.pdf>.

⁶²Po aty.

⁶³Shënim: Sipas dokumentit me komente të KPK-së dërguar nëngrupit të II-të punues – Sfidat e sistemit të drejtësisë, mundësitë dhe pamundësitë e adresimit të tyre, datë 23 shtator 2020.

Sipas përfaqësuesve të KPK-së, me qëllim të fuqizimit të procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve, KPK është në proces të ndryshimit të Rregullores e cila pritet të hyjë në fuqi me 1 janar 2021. Kjo rregullore do të adresojë sfidat të cilat janë paraqitur ndër vite. Për më tepër në këtë rregullore:

- Është paraparë vlerësimi jo i rregullt
- janë përcaktuar qartë indikatorët për vlerësimin e performancës,
- pesha e vlerësimit të indikatorëve,
- është avancuar vlerësimi i prokurorëve nga eprori.
- Janë pasqyruar efektet e vlerësimit.⁶⁴

Sfidat

Një ndër sfidat gjatë procesit të vlerësimit ka qenë angazhimi i anëtarëve të Komisionit me punë të përhershme si prokurorë si dhe angazhimit shtesë në Komision e që kërkon përkushtim dhe kohë për të arritur në një proces efikas dhe sa më të saktë.⁶⁵

Në anën tjetër, sa i përket vlerësimit të performancës së gjykatësve, është komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjykatësve në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni i cili bën vlerësimin e performancës së gjyqtarëve përbëhet nga 13 anëtarë. Përbërja e Komisionit përfaqëson shkallshmerinë e sistemit gjyqësor asisoj që nga Gjykata Supreme caktohen 5 gjyqtarë , nga Gjykata e Apelit caktohen 4 gjyqtarë dhe nga radhët e gjykatave themelore caktohen 3 gjyqtarë . Gjyqtarët e caktuar ne Komision duhet të kenë se paku 5 vite përvojë pune si gjyqtar nga lëmi civil dhe penal.⁶⁶

Performanca e gjyqtarëve me mandat të përhershëm vlerësohet çdo tri (3) vjet për secilin gjykatës. Këshilli Gjyqësor çdo fund vit nxjerr vendim për përzgjedhjen e një të tretës së gjyqtarëve për vlerësim, ndërsa për gjyqtarët e rinj, vlerësimi i performancës së gjyqtarëve bëhet dy herë brenda tri viteve.⁶⁷

Sa i përket vlerësimit të performancës së gjyqtarëve për vitin 2017 janë vlerësuar 66 gjyqtarë, ku 2 prej tyre kanë qenë me mandat fillestar, 54 me mandat të përhershëm, të përzgjedhur sipas metodës së rastësishme, dhe 10 gjyqtarë që janë kandidatë për ngritje në detyrë. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve ka mbajtur rreth 30 takime. Anëtarët raportues të Komisionit kanë monitoruar 66 gjyqtarët që kanë qenë pjesë e procesit

⁶⁴Po aty.

⁶⁵Shënim: Sipas dokumentit me komente të KPK-së dërguar nëngrupit të II-të punues – Sfidat e sistemit të drejtësisë, mundësitë dhe pamundësitë e adresimit të tyre, datë 23 shtator 2020.

⁶⁶Qasja në drejtësi - Raport i monitorimit në gjykatat themelore në Republikën e Kosovës për periudhën tetor 2018 – shtator 2019; Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet “ÇOHU”, nëntor 2019 Prishtinë - <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-hulumtime/Qasja-ne-drejttesi-218>.

⁶⁷Po aty.

të vlerësimit të performancës, dhe gjithashtu kanë realizuar intervista me gjyqtarët që kanë qenë subjekt i vlerësimit.⁶⁸

3.3 Masat dhe avancimet

3.3.1 Rezultatet e mekanizmave të performancës dhe disiplinimit

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve 06/L -057 ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019 ndërsa zbatimi i Ligjit ka filluar në korrik 2019, ndërsa si rrjedhojë e këtij Ligji Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial kanë nxjerrë rregulloret përkatëse.

Me këtë Ligj është zhvendosur hetimi dhe vendosja lidhur me rastet e pretenduara disiplinore nga Zyra e Prokurorit Disiplinor tek Autoritetet Kompetente - Kryeartët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët si instanca e parë e trajtimit të ankesave disiplinore, për të vazhduar më pas me themelimin e paneleve hetimore në Këshillat përkatës ndërsa vendimmarrja përfundimtare lidhur me rezultatet e hetimeve ka mbetur tek Këshillat.

Para hyrjes në fuqi të Ligjit të ri, Zyra e Prokurorit Disiplinor në vazhdimësi është kritikuar për mungesën e rezultateve konkrete në disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërsa me Ligjin e ri është synuar që në mënyrë drastike të përmirësohet ky mekanizëm i llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ndonëse në fazën embrionale, Ligji i ri për Përgjegjësinë Disiplinore, nuk ka dhënë rezultatet e pritura deri më tani.

Të dhënat e nxjerra nga organizatat e shoqërisë civile eidentojnë se që nga korriku i vitit 2019 deri në gusht 2020, vetëm 4 % e rasteve të iniciuara disiplinore kanë përfunduar me sanksione disiplinore ndaj gjyqtarëve, ndërsa në vetëm 13% të rasteve Autoritetit Kompetent ka aprovuar ankesat dhe ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

4 vendime vërejtje jopublike me shkrim

1 vendim lirim nga përgjegjësia

1 vendim zvogëlim i pagës për 30% për 3 muaj

1 vendim zvogëlim i pagës 30% 4 muaj

1 vendim zvogëlim i pagës 30% 6 muaj

1 vendim zvogëlim i pagës 10 % 4 muaj

⁶⁸Raporti vjetor 2017 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës :[file:///C:/Users/Hp/Downloads/Raporti%20Vjetor%20i%20KGIK-%202017%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Hp/Downloads/Raporti%20Vjetor%20i%20KGIK-%202017%20(1).pdf)

Këto të dhëna pa mëdyshje evidentojnë një numër tepër të vogël të rasteve që kanë përfunduar me sanksion disiplinor edhe po ashtu evidentojnë se afër 50% e rasteve është shqiptuar vërejtje jo publike me shkrim si sanksioni më i lehtë disiplinor.

Disiplinimi i Prokurorëve

Sipas Këshillit Prokurorial të Kosovës, deri në vitin 2019, Këshilli përmes Komisionit Disiplinor ka trajtuar rreth 100 procedura disiplinore ndaj prokurorëve. Prej tyre janë shqiptuar rreth 50 masa disiplinore, disa nga të cilat ishin suspendime me pagesë, suspendime pa pagesë, ulje në detyrë brenda sistemit prokurorial dhe shkarkim nga detyra e prokurorit të shtetit.

Procesi i disiplinimit të prokurorëve ka pësuar ndryshime me hyrjen në fuqi të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.⁶⁹

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Këshilli ka shqiptuar këto masa:

- 4 vendime “Nuk ka kryer shkelje”
- 1 Transferim i përhershëm nga pozita e prokurorit të Departamentit të Krimeve të Rënda, në Departament të Përgjithshëm
- 5 vërejtje jo publike me shkrim
- 2 zvogëlim i përkohshëm i pagës për 30% për një periudhë 6 mujore
- 1 zvogëlim i përkohshëm i pagës për 50% për një periudhë 1 vjeçare (me vendim të Gjykatës Supreme është ndryshuar në: Zvogëlim i përkohshëm i pagës 50% për 6 muaj).⁷⁰

3.3.2 Vlerësimi i Performancës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Aktualisht Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial janë në procedurë të nxjerrjes së rregulloreve për vlerësim të performancës për gjyqtarë e prokurorë dhe po synojnë përmirësimin e këtij mekanizmi duke kaluar nga një vlerësim kuantitativ drejtë një vlerësimi më kualitativ për gjyqtarë dhe prokurorë.

Deri më tani, ky mekanizëm pothuajse në plotëni ka dështuar të përmbushë qëllimin e këtij mekanizmi për të përmirësuar cilësinë e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Vlerësimi i Performancës së Gjyqtarëve

⁶⁹Po aty.

⁷⁰Shënim: Sipas dokumentit me komente të KPK-së dërguar nëngrupit të II-të punues – Sfidat e sistemit të drejtësisë, mundësitë dhe pamundësitë e adresimit të tyre, datë 23 shtator 2020.

Të dhënat e siguruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për vlerësimin e performancës për vitet 2017, 2018 dhe 2019 evidentojnë se asnjë gjyqtar nuk është vlerësuar dobët me çka do t'i haptë rrugë mundësisë së shkarkimit të tij.

Gjithashtu, pasur parasysh numrin e lëndëve të parashkruara, numrin e lëndëve të pazgjidhura, numrin e aktgjykimeve të prishura, rastet kur vetë Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykatat e rangut më të ulët kanë vendosur gabimisht në favor të akuzuarve, atëherë mund të konstatojmë se ky mekanizëm nuk ofron një pasqyrë të qartë të performancës së gjyqtarëve dhe cilësisë së punës së gjyqtarëve.

Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve për vitin 2017

Vlerësimi i performancës 2017	
1-30 pikë (dobët)	0
31-50 pikë (mirë)	3
51-80 pikë (shumë mirë)	56
Mbi 81 pikë (shkëlqyeshëm)	3
Gjithsej	62

Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve për vitin 2018 dhe 2019

Vlerësimi i performancës 2018	
1-30 pikë (dobët)	0
31-50 pikë (mirë)	1
51-80 pikë (shumë mirë)	58
Mbi 81 pikë (shkëlqyeshëm)	1
Gjithsej	60
Vlerësimi i performancës 2019	
1-30 pikë (dobët)	0
31-50 pikë (mirë)	0

51-80 pikë (shumë mirë)	36
Mbi 81 pikë (shkëlqyeshëm)	4
Gjithsej	40

Vlerësimi i Performancës së Prokurorëve

Sikurse tek vlerësimi i performancës së gjyqtarëve, edhe vlerësimi i performancës të Prokurorëve nga Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk ka treguar rezultat të kënaqshëm mirëpo për dallim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në vitin 2019 ka pasur një lëvizje pozitive teksa është aplikuar vlerësimi i jashtëzakonshëm i performancës që ka rezultuar me 2 raste kur prokurorët janë vlerësuar ‘pamjaftueshëm’.

Vlerësimi i performancës 2018	
Pamjaftueshëm	0
Mjaftueshëm	3
Mirë	23
Shumë mirë	40
Gjithsej	67

Vlerësimi i performancës 2019	
Pamjaftueshëm	2
Mjaftueshëm	2
Mirë	27
Shumë mirë	59
Gjithsej	90

Procedurat, masat disiplinore dhe avancimet

Rregullat mbi etiken dhe sjelljen e gjyqtareve synojnë të krijojnë, ruajnë, dhe forcojnë rregullat e sjelljes si dhe të rrisin efikasitetin e të gjithë gjyqtareve në ushtrimin e funksioneve Kushtetuese dhe ligjore, në interes të publikut dhe në emër të shtetit të drejtës. Rregullat, përkrahin zbatimin e standardeve të larta të sjelljes profesionale të gjyqtareve të gjitha niveleve, me qëllim forcimin e dinjitetit, pavarësisë dhe integritetit profesional e personal të tyre.

Pra këto rregulla shërbejnë për të gjithë gjyqtaret dhe prokurorët, për të rritur ndërgjegjësimin, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në ushtrimin e funksioneve të tyre, e po ashtu rregulla kanë për qëllim që të vejnë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të këtë gjyqtari i Republikës së Kosovës.

Me kuptimin e drejtë të rregullave të sjelljes, gjyqtaret në Kosovë kanë vetëdije me të madhe për përgjegjësinë e tyre etike, në detaje dhe janë në gjendje të veprojnë në përputhje me standardet me të larta dhe të mbrojnë veten e tyre nga rreziqet e shkeljeve të paqëllimshme të rregullave etike dhe nga ankesat e mundshme apo edhe nga masat disiplinore.

4. MODALITETET E LLOGARIDHËNIES DUKE PËRFSHIRË EDHE VETINGUN

Në kuadër të këtij kapitulli prezantohen katër opsione apo skenarë të cilat do mund të operoheshin në përgjigje të problemeve të identifikuara në këtë Raport. Opsioni i parë është vazhdimi i status quo-së apo gjendjes ekzistuese, pastaj opsioni i dytë adreson problemet përmes ndryshimeve ligjore që kanë të bëjnë me llogaridhënien, opsioni i tretë parasheh mundësinë e adresimit të të metave në llogaridhënie, përmes masave të kombinuara, përkatësisht, vetingut në njërën anë dhe përmirësimit të performancës dhe disiplinimit përmes ndryshimeve ligjore në anën tjetër, ndërkaq opsioni i katërt sheh si zgjidhje zhvillimin e veting-ut për gjyqtarë dhe prokurorë. Ky kapitull analizon benefitet dhe të metat e secilit opsion duke pasqyruar se sa në fakt do përmirësohet llogaridhënia në sistemin e drejtësisë varësisht se cili opsion zgjedhet.

4.1 Opsioni i - *Status Quo*

Aktualisht në Republikën e Kosovës ekzistojnë shumë sfida që e shoqërojnë sistemin e drejtësisë. Ndër to më evidentet janë mungesa e llogaridhënies dhe integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Vlen të theksohet se ndonëse gjendja nuk është e kënaqshme, infrastruktura ligjore që adreson sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës konsiderohet se është në përgjithësi mjaft e konsoliduar. Organizimi, funksionimi dhe llogaridhënia e sistemit të drejtësisë rregullohen ndër të tjera me aktet si: Kushtetuta, Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorin e shtetit, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe me një gamë aktesh nënligjore gjegjëse. Ashtu siç është momentalisht e rregulluar me ligj, prokurorët dhe gjyqtarët e Republikës së Kosovës, pas mandatit fillestar tre (3) vjeçar, mandatohen përhershëm deri në pensionim dhe mund të shkarkohen vetëm në rast të dënimit për vepër të rëndë penale ose mosrespektimit të rëndë të detyrave.

Sipas ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të kryejnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ku një gjë e tillë garantohet nga Këshilli Prokurorial, respektivisht ai Gjyqësor i Kosovës, të cilët rekrutojnë, propozojnë, avancojnë, transferojnë dhe dispiplinojnë prokurorët, gjegjësisht, gjyqtarët. Për më tepër, legjislacioni aktual përcakton se llogaridhënia dhe transparenca janë vlera themelore me të cilat duhet të udhëhiqen profesionistët e drejtësisë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duke kryer detyrat e tyre me përgjegjshmëri, nivel të lartë profesional, transparencë dhe efikasitet. Njëkohësisht të njëjtit, sipas ligjit, duhet të kenë karakter të lartë moral dhe profesional.

Mirëpo, problemi kryesisht qëndron se në praktikë llogaridhënia dhe integriteti i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk janë në nivelin që normativa ligjore e Republikës së Kosovës e proklamon të nevojshme. Një gjë e tillë argumentohet nga qytetarët në përgjithësi, shoqëria civile madje dhe akterë ndërkombëtarë të shumtë.

Sot, sistemi i drejtësisë në Kosovë konsiderohet si një nga hallkat më të brishta të shtetësisë dhe i cili është lehtë i ndikueshëm nga politika. Duke rikujtuar që organet e drejtësisë janë të thirrura për të mbajtur në përgjegjësi të gjithë të tjerët që bien ndesh me ligjin, kjo performancë e dobët e sistemit të drejtësisë konsiderohet se ndikon edhe në shtrembërimin e demokracisë në vend. Është evidente se kontribuues të gjendjes në të cilën ndodhen sot sistemin e drejtësisë është tranzicioni nëpër të cilin ka kaluar Republika e Kosovës qysh nga paslufta e pastaj shtet formimi. Pasojat e drejtësisë tranzicionale kosovare vërehen edhe sot, pasi që vetëm në vitin 2018 përgjegjësitë ekzekutive iu mvëshën në totalitet mekanizmave vendorë. Shtuar kësaj, sistemi i drejtësisë është përballur vazhdimisht me krijimin e institucioneve të reja dhe ndryshimet strukturore krahas organeve të drejtësisë si dhe me ndryshime të kornizës ligjore. Problem tjetër evident, pasojat e të cilit edhe aktualisht janë eminente, sidomos lidhur me zvarritjen e lëndëve, ka qenë numri i vogël i prokurorëve dhe gjyqtarëve ku vetëm tani konsiderohet se të njëjtit janë të mjaftueshëm në numra. Për më tepër, siç u përmend më lartë, për momentin ndër mangësitë më të theksuara të sistemit të drejtësisë, konsiderohet mungesa e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky qalim në integritet vlerësohet të jetë i afektuar nga ndikimet e politikës, pastaj ekzistimi i grupeve të interesit, si dhe konflikti i interesit që konsiderohet i pranishëm në sistemin e drejtësisë, për të cilat është shkruar më sipër në këtë dokument.

Hiq më pak e rëndësishme është edhe mungesa e llogaridhënies në kuadër të sistemit të drejtësisë. Krahas kësaj, drejtësia në Kosovë ballafaqohet me keq menaxhim të lëndëve dhe shkallën e lartë të parashkrimit, ku siç është cekur në këtë dokument, numrat e lëndëve të parashkruara në njëzet vitet e fundit kapin vlerën e mbi 25 mijë lëndëve për periudhën 2000-2019. Po ashtu është e dukshme mungesa e performancës reale të gjyqtarëve dhe prokurorëve tanë, e cila pasqyrohet, dhe jo vetëm, në mos përgatitjen e duhur të akuzave, numrin e rasteve kur prokurorët kërkojnë shtyrjen e gjykimeve si pasojë e mos përgatitjes. Tjetër argument që zbehë llogaridhënien e organeve të drejtësisë është shkelja e afateve procedural ligjore në procedurat hetimore dhe nga momenti që shkojnë në gjykatë.

Me gjithë problemet e identifikuar, mekanizmat ekzistues janë mjaftë bujar me vlerësimet që i'u bëjnë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për ilustrim, në tri vitet e fundit mekanizmi për vlerësimin e performancës nuk ka vlerësuar dobët asnjë gjyqtarë. Duke parë në anën tjetër të gjitha raportimet për keqpërdorime dhe punë të dobët që bëhet jo rrallëherë në kuadër të organeve të drejtësisë, mund të konkludohet se mekanizmat ekzistues nuk ofrojnë një pasqyrë të qartë të performancës dhe punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Hiç më mirë nuk

qëndron çështja e disiplinimit, ku rrallë herë procedura disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë rezulton me sanksionim, dhe madje kur kjo ndodhë, sanksioni është shumë i butë. Ndonëse, janë ndërmarrë hapa në drejtim të zbutjes së këtyre problemeve, në formën e ligjeve dhe akteve nën-ligjore⁷¹, theksohet se për më shumë se një dekadë janë bërë përpjekje që këto probleme të adresohen përmes nismave ligjore. Megjithatë, masat e ndërmarra në formë të hartimit të legjislacionit si instrument primar, nuk kanë treguar rezultate të kënaqshme në zbatim.

Duke marrë për bazë të gjitha këto, vlerësohet se nëse shkohet me opsionin *status quo*, sfidat dhe problematikat e identifikuara në kapitullin 2 të këtij Raporti do vazhdojnë të ekzistojnë, madje me shumë gjasë edhe të përshkallëzohen. Kështu, do vazhdohet të ketë mungesë të rezultateve konkrete në luftimin e kriminalitetit si dhe zgjidhjen e kontesteve, e po ashtu perceptimi rreth integritetit dhe llogaridhënies në kuadër të organeve të drejtësisë dhe besimi i qytetarëve do degradonin dhe më tej. Ndërkaq, nga ana tjetër konsiderohet se zgjedhja e këtij opsioni nuk do sjellë ndonjë benefit që do reflektohej me sistem të drejtësisë me llogaridhënie të kënaqshme. Kjo thënë duke pasur parasysh edhe progreset sporadike që evidentohen në kuadër të sistemit ndër vite.

4.2 Opsioni II - Ndryshimet ligjore dhe kushtetuese

4.2.1 Ndryshimet konkrete ligjore në sistemin Prokurorial

Sa i përket sfidave të evidentuara më lartë në këtë dokument të grupit punues, se nuk është e nevojshme të bëhen ndryshime kushtetuese. Ndërsa ndryshimet ligjore, apo hartimi i akteve të reja janë të domosdoshme me qëllim të avancimit të sistemit prokurorial të Kosovës në realizimin e mandatit të tij.

Ndryshimet ligjore janë si në vijim:

1. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Çështjet ku konsiderojmë se Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës mund të ndryshojë janë si në vijim:

- Përbërja dhe funksionimi i Këshillit

Ndryshimet ligjore duhet të përcaktojnë numrin e anëtarëve, bazën deleguese dhe të përcaktohen kriteret që kandidatët duhet të plotësojnë për tu zgjedhur si anëtarë të Këshillit. Të diskutohet numri i anëtarëve të KPK, kompetencat dhe raporti me Kryeprokurorin e Shtetit.

⁷¹ Shih për shembull: Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve; Rregullorja nr. 05/2020 për vlerësimin e performancës së Prokurorëve.

Një nga kompetencat kryesore është që kryeprokurorët e prokurorive të Kosovës propozohen nga Kryeprokurori i Shtetit dhe pastaj emërohen nga Këshilli.

- Vlerësimi i performancës

Përmes ndryshimeve ligjore (Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit) sa i përket vlerësimit të performancës të qartësohen çështjet e mëposhtme:

- kriteret e vlerësimit (integriteti duhet të jetë kategori e veçantë ndaras prej vlerësimit të performancës)
- autoritetet vlerësuese – të fuqizohet roli i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të performancës (kryeprokurorëve të prokurorive dhe Kryeprokurorit të Shtetit)
- dy shkallshmëria – të mundësohet që Këshilli të jetë instanca e dytë dhe e fundit në procesin e vlerësimit të performancës

- Themelimi i trupave të Këshillit (mekanizmat për integritet dhe llogaridhënie)

Me qëllim të fuqizimit të integritetit të kandidatëve për prokurorë dhe prokurorëve që janë në detyrë si dhe procesin e llogaridhënies të parashihet themelimi i mekanizmave të përhershëm si trupa të Këshillit të përbërë nga prokurorë me integritet të lartë dhe performancë të dalluar, të cilët do të mbikëqyrin integritetin dhe llogaridhënien në mënyrë të vazhdueshme (në periudha 3 ose 5 vjeçare).

- Rekrutimi i prokurorëve

- Me ndryshimet ligjore të qartësohet përvoja e punës relevante për kandidatet për emërim fillestar bazuar në këtë të vendoset se cilët candidate do të ndjekin trajnimin fillestar para emërimit e cilët pas emërimit
- Lëvizja e ndërsjellët në mes gjyqtarëve dhe prokurorëve të behet me vendime në mes të KPK dhe KGJK
- Të përcaktohet obligimi për shërbim në sistem prokurorial për një periudhë të caktuar pas përfundimit të trajnimit fillestar

2. Ligji për Prokurorin e Shtetit

Çështjet ku konsiderojmë se Ligji për Prokurorin e Shtetit mund të ndryshojë janë si në vijim:

- Përgjegjësitë dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit

- Të fuqizohet roli i Kryeprokurorit të Shtetit në administrimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit.
- Të qartësohen kompetencat mes Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

- Të fuqizohet llogaridhënia e prokurorëve përmes fuqizimit të rolit mbikëqyrës të eprorëve (vlerësimi i performances dhe zbatimi i udhëzimeve të detyrueshme të eprorëve)
- Vlerësimi i performancës (duhet të ndryshohen ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe ligji për Prokurorin e Shtetit)
- Propozimi për Kryeprokurorë (duhet të ndryshohen ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe ligji për Prokurorin e Shtetit)
- Kriteret për emërim të kandidatëve për prokurorë (duhet të ndryshohen ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe ligji për Prokurorin e Shtetit)ku parashihen kriteret për emërim)

3. Ligji për përgjegjësinë disiplinore

- Disiplinimi
 - Të parashihet pezullimi i prokurorëve gjatë fazës së procedurës disiplinore
 - Të parashihet roli i KPK-së në trajtimin e vendimeve për hudhje të ankesës nga Autoriteti Kompetent
 - Të qartësohen subjektet që mund të parashtrojnë ankesë ndaj vendimeve të KPK-së në Gjykatën Supreme

4. Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

Të plotësohet dhe ndryshohet ligji për Prokurorin e Shtetit dhe ligji aktual për PSRK ku do të përcaktohen kompetencat, përgjegjësitë dhe organizimi i brendshëm i PSRK-së.

5. Ndryshimet në çështjen e buxhetit

Të harmonizohen dispozitat me Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës sa i përket buxhetit dhe të përcaktohet se, Këshilli pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe i'a dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Këshilli. Buxheti i propozuar nga Këshilli përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

Këshilli menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

6. Pozita e administratës së sistemit prokurorial (aktgjykimi)

Sa i përket statusit të administratës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me aktgjykimin Nr. ref.:AGJ 1583/20 të datës 9 korrik 2020 ka konstatuar pavarësinë e administratës së sistemit prokurorial në raport me ekzekutivin.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se nëpunësit civilë të sistemit prokurorial janë nëpunës civilë me status të veçantë kjo për arsye se parimi i ndarjes së pushtetit është i garantuar me nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës si dhe pavarësia e sistemit prokurorial është e garantuar me nenet 109 dhe 110 të Kushtetutës.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se institucionet e pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuara që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Rregullimet të cilat krijojnë “ndërhyrje” të drejtpërdrejtë në pavarësinë funksionale dhe organizative të tyre janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parimet e vlerat e proklamuar aty.

Me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është obliguar Kuvendi i Kosovës që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në mënyrë që të njeh të drejtën e KPK-së për nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të brendshme, sa i përket çështjeve të strukturës organizative të funksionimit, klasifikimit të pozitave, kushteve të veçanta për rekrutim, orarit të punës si dhe të drejtave dhe detyrimeve specifike të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë, në mënyrë analoge siç parashihet për nëpunësit e Kuvendit, ku Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështje të caktuara të nëpunësve të saj civil.

Sa i përket administratës së sistemit prokurorial, propozimi ynë është që pavarësisht nga ndryshimet ligjore që do të ndodhin, duhet të ruhet pavarësia e sistemit prokurorial e garantuar me këtë aktgjykim.

Forma dhe modalitetet e verifikimit të integritetit në Kosovë

Verifikimi i integritetit të bëhet pas ndryshimeve ligjore në atë mënyrë që të parashihet një mekanizëm i brendshëm i kontrollit të integritetit në fazën e emërimit fillestar për prokurorët e rinj dhe i njëjti mekanizëm të shërbejë edhe për verifikim të vazhdueshëm të integritetit për prokurorët në detyrë.

Ky mekanizëm do të jetë i përhershëm i sistemit prokurorial me përbërje nga prokurorë me reputacion të lartë dhe integritet të pakontestueshëm të cilët do të verifikohen fillimisht dhe do të jenë plotësisht të pavarur në punën e tyre sipas kritereve të përcaktuara me ligj. Zgjedhja e tyre do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Sfidat dhe problemet qe zgjidh verifikimi i integritetit

- Llogaridhënia
- Performanca
- Profesionalizmi
- Integriteti dhe
- Besimi i publikut.

4.2.2 Ndryshimet ligjore për gjyqëtorin

Këshilli Gjyqësor i Kosovës aktualisht mekanizma të brendshëm të cilat sigurojnë llogaridhënien dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor. Më poshtë janë të paraqitura mekanizmat ekzistues si dhe ato të planifikuara për të ardhmen e për të cilat Këshilli është duke punuar në këtë drejtim.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Ky ligj përcakton kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Në këtë mënyrë procesi i vlerësimit të performancës së rregullore të gjyqtarëve, për avancim të gjyqtarëve si dhe gjyqtarëve me mandat fillestar është instaluar si proces i përhershëm dhe synon të masë performancën e secilit gjyqtarë. Si mekanizëm i drejtpërdrejtë i llogaridhënies gjyqësore, sistemi i vlerësimit të performancës jo vetëm që vlerëson punën profesionale të gjyqtarit në baza të rregullta kohore, por mes tjerash, shërben edhe si mekanizëm kontrolli i arritjes së objektivave të gjykatave në ngritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit.

Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të këtij procesi, Këshilli në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar ka punuar vazhdimisht në plotësim ndryshimin e rregullores së Vlerësimit të Performancës së gjyqtarëve. Kriteret e vlerësimit të performancës ndër vite janë definuar, përmirësuar duke fokusuar në vlerësimin e punës profesionale, sjelljen jashtë zyrës dhe integritetin personal. Kjo tregon qarte përkushtimin e gjyqësorit të përmirësojë objektivitetin dhe integritetin e procesit të vlerësimit të performancës.

Për më tepër, propozim ndryshimet e fundit në shqyrtim e sipër nga Këshilli kanë për qëllim të përforcojnë edhe më tej procesin, duke përzgjedhur anëtarët e komisionit të vlerësimit të performancës përmes një procesi të hapur dhe konkurrues, duke anonimizuar fazën e parë të vlerësimit të performancës, duke fshehur identitetin e gjyqtarit i cili do të vlerësohet si dhe gjyqtarit i cili kryen vlerësimin. Gjithashtu, në bazë të kësaj rregullore për secilin kriter vlerësues, anëtarë të Komisionit duhet të jap arsyetimin se si gjyqtari vlerësues ka arritur deri te rezultati apo vlerësimi i caktuar. Ndër të tjerash, vlerësimi i performancës është bazë për iniciimin e procedurës për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit. Të gjitha këto ndryshime kanë për qëllim përforcimin e mekanizmave të brendshëm llogaridhënës dhe janë indikator i

qartë i përpjekjeve dhe punës së Këshillit për të ngritur kualitetin, efikasitetin dhe integritetin e gjyqësorit

Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Ndër mekanizmat e tjerë llogaridhënës që ndihmojnë gjyqësorin të sigurojë integritetin e gjyqtarëve është edhe procesi i disiplinimit të Gjyqtarëve, i cili rregullohet me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Hyrja në fuqi e këtij ligji e ka reformuar plotësisht sistemin e disiplinimit të gjyqtarëve. Këshilli është angazhuar në hartimin e rregullores dhe në këtë drejtim ka punuar me partnerët ndërkombëtar.

Për dallim nga e kaluara sistemi i ri disiplinor ka decentralizuar proceset nga regjistrimi dhe shqyrtimi i ankesave fillestare kundër gjyqtarëve e tutje. Kështu në këtë proces është arrit që të ketë përfshirje më të madhe duke filluar nga qytetarët, Kryetarët e gjykatave, Avokatin e Popullit, panelet hetimore të cilat janë në përbërje nga gjyqtarë të ndryshëm për secilin rast dhe krejt në fund anëtarët e Këshillit. Në këtë mënyrë është krijuar një lloj shkallshmërie e cila siguron që procesi disiplinor dhe vendimmarrja të jetë e pavarur dhe e paanshme.

Nga ky Ligj, kemi një tjetër mekanizëm llogaridhënës që për herë të parë në gjyqësor vendimet disiplinore ndaj gjyqtarëve publikohen me të dhënat e gjyqtarit përkatës.

Pra, përmes këtij procesi do të sigurohet që gjyqtarët të jenë përgjegjës dhe të përmirësohet besimi i publikut.

Për me shumë, Këshilli ka miratuar rregulloren për Trajnimin e Gjyqtarëve, e cila parasheh që njëra ndër temat për trajnimin e obligueshëm të gjyqtarëve të jetë tema për çështjet e Etikës profesionale. Gjyqtaret sigurohen që të paktën 20% e periudhës kohore të përcaktuar nga orët e trajnimit obligativ vjetor të kalohen në trajnime për çështje të etikës profesionale.

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, në rastet e rekrutimit të gjyqtarëve përveç kriterëve në lidhje me njohuritë profesionale, Këshilli duhet të sigurojë edhe verifikimin standard të së kaluarës kriminale të secilit kandidatë. Ndër të tjerat kjo ndërlidhet edhe me integritetin personal, në këtë formë Komisionet rekrutuese dhe anëtarët e Këshillit informohen për secilin kandidatë. Ky proces, bëhet me qëllim të sigurohet që gjyqtarët e ardhshëm të kenë integritet personal dhe të evitohet mundësia që persona jo adekuatë të përfshihen në sistemin gjyqësor.

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, Këshilli ka miratuar edhe Rregulloren për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilën ka krijuar Njësinë për mbështetjen e Komisioneve për Rekrutim, Avancim dhe Disiplinim. Kjo Njësi, ofron mbështetje profesionale duke i njoftuar komisionet mbi raportet e verifikimit standard të së kaluarës kriminale për secilin kandidatë.

Duke pas parasysh që llogaridhënia dhe transparenca ndërlidhen ngushtë me njëra tjetrën, Këshilli është angazhuar vazhdimisht në këto drejtime. Prandaj, Këshilli çdo tre muaj publikon në ueb-faqe shkallën e efikasitetit dhe të dhënat mbi zgjidhjen e lëndëve të vjetra për secilën gjykatë. Ndërsa, ajo që vlen të theksohet është publikimi i të dhënave individuale për produktivitetin e secilit gjyqtarë. Publiku dhe të gjithë të interesuarit mund të informohen shumë lehtë për punën dhe lëndët që i zgjidhin secili gjyqtarë.

Gjithashtu, Këshilli ka edhe Njësine për Inspektim Gjyqësor që ka kompetencë e inspektimit të çështjeve konkrete që lidhen me gjykata, gjyqtarë dhe segmente specifike të administratës gjyqësore. Një gjë e tillë e shndërron Njësine në një mekanizëm të rëndësishëm të rishikimit të tërë ciklit gjyqësor, nga politik bërja e zbatimi i përgjithshëm i ligjeve e deri tek rastet konkrete të rregullsisë e performancës së gjykatave e gjyqtarëve. Kjo Njësi, zhvillon studime për të vlerësuar efikasitetin e procedurave gjyqësore, ndikimin e ligjeve, rregulloreve dhe politikave të Këshillit si dhe bën rekomandime për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e gjyqësorit.

4.2.3 Propozimi për Gjyqësorin

Përveç mekanizmave ekzistues të llogaridhënies të cilat funksionojnë aktualisht, Këshilli Gjyqësor është duke shqyrtuar mundësinë e krijimit të një procesi të verifikimit të gjyqtarëve të cilët shërbejnë në sistemin gjyqësor të Kosovës, dhe atë brenda çdo periudhe 3 vjeçare kur me rregulloret ne fuqi bëhet edhe vlerësimi i rregullt i performancës profesionale të secilit gjyqtar. Ky proces do të zhvillohet nga Këshilli përmes Njesisë për Mbështetjen e Komisioneve për Rekrutim, Avancim dhe Disiplinim, ku përmes këtij procesi parashikohet të bëhet një verifikim (skanim) i tërësishëm për secilin gjyqtar. Në lidhje me verifikimet do të informohet Këshilli dhe do të merren masat sipas legjislacionit në fuqi.

Si përfundim, vlerësohet se Opsioni II paraqet konceptin se si mendohet të mbështeten reformat në sistemin e drejtësisë si pjesë e rishikimit funksional duke përfshirë edhe modalitetin për integritetin si objektivë për ndryshim. Përmes këtyre propozimeve sipas KPK-së dhe KGjK-ja kanë adresuar disa nga sfidat aktuale dhe zgjidhjet më të mira për tejkalimin e tyre në përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor. Lidhur me detajimin e këtyre çështjeve sistemi prokurorial dhe gjyqësor është i përkushtuar dhe i gatshëm për bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante të përfshira në këtë proces.

4.3 Opsioni i kombinuar: Krijimi i mekanizmave për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ndryshimet ligjore për disiplinimin dhe performancën e tyre.

Ky opsion elaboron mundësinë e ndryshimit të gjendjes jo të kënaqshme në të cilën janë dhe funksionojnë organet e sistemit të drejtësisë në vend, përmes, të themi, një kombinimi të opsionit 2 dhe 4 të këtij Raporti.

Kjo nuk duhet kuptuar si pajtim i këtij opsioni me opsionet 2 dhe 4 të Raportit, me të cilat opsioni 4 në fakt gjen edhe kundërshtime thelbësore.

Kështu, ky opsion 'mix' thërret në adresimin e përmirësimit të gjendjes së sistemit të drejtësisë si përmes aprovimit dhe zhvillimit të *vetingut*⁷², ashtu edhe përmes ndërhyrjeve të tjera ligjore dhe operative që adresojnë elementet e tjera ku stagnon llogaridhënia, performanca dhe efikasiteti i atyre që vënë drejtësinë.

Fillimisht duhet parë arsyeshmëria e operimit të këtij opsioni. Lidhur me këtë konsiderohet se zgjedhja e tij do ofronte përmirësime të vërteta sa i përket rritjes së llogaridhënies dhe integritetit në krahasim me tre opsionet e tjera të ofruara.

Kjo fillimisht pasi që sa i përket segmentit të parë të këtij opsioni –integritetit - modeli i vetingut i ofruar në opsionin 4 është mjaftë strikt, mund të rezultojë me stagnim të sistemit të drejtësisë për një periudhë kohore, dhe nuk arrin të shtyjë ruajtjen e integritetit përherë gjatë ushtrimit të mandatit.

Tutje, opsioni status quo, është e qartë se do i shtonte jetëgjatësinë problemeve të drejtësisë dhe problemeve me drejtësinë në Kosovë, mirëpo edhe opsioni 2, kështu siç është paraqitur, nuk i shkon shumë larg zgjedhjes së status quo-së.

Më konkretisht, sa i përket segmentit të dytë – performancës dhe disiplinimit –, theksohet se për më shumë se një dekadë janë tentuar ndryshime ligjore si mjeti për të përmirësuar gjendjen në sistemin e drejtësisë. Ende nga përfaqësuesit shumicë të sistemit të drejtësisë ndryshimet ligjore dhe nënligjore janë zgjidhja shabllon për adresimin e të gjitha problemeve që ka sistemi. Por sa kanë rezultuar të jenë efektive këto ndryshime deri tani, nuk merret parasysh. Këto nuk merren parasysh as nga opsioni 2 i propozuar.

Rikujtohet se vetëm Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është ndryshuar 5 herë deri tani brenda 10 viteve, qysh nga hyrja në fuqi e ligjit bazik. Ngjashëm qëndron puna edhe me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorin e shtetit. Madje edhe Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve i cili ka hyrë në fuqi vetëm në fillim të vitit të kaluar, tani po kalon një proces të plotësimit dhe ndryshimit dhe prapë se prapë në opsionin 2 të këtij Raporti rekomandohet që ky ligj të ndryshohet edhe më tutje.

Por në praktikë, rezultatet që shihen nga raporte vendore dhe ndërkombëtare flasin se ndryshimet legislative deri tani, të paktën si masë e vetme adresimi, nuk janë të suksesshme.

⁷² Shprehja veting këtu nënkupton kontroll të vazhdueshëm të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, siç shpjegohet më poshtë në këtë opsion, dhe kjo shprehje përdoret përbrenda këtij opsioni vetëm për shkak të familjaritetit që ky term ofron sa i përket kontrollit të integritetit.

Me anë të ndryshimeve ligjore për mekanizmat ekzistues arrihen kryesisht vetëm përmirësime estetike dhe simbolike të sistemit të drejtësisë në vend.

Ndonëse vitet po shkojnë dhe adresimi përnjëmend i përmirësimit të llogaridhënies dhe integritetit nuk ka ndodhur ende, sillet ndërmend se është detyrë e çdo shteti të respektoj të drejtat e njeriut. Këtu përfshirë të drejtën në gjykim të drejtë, me cënimin e së cilës organet e drejtësisë humbasin kredibilitetin dhe esencën e tyre.

Nuk është e udhës të thirret në parimin e mosndërhyrjes në sistemin e drejtësisë nëse ky parim ashtu siç po interpretohet dhe ndoshta edhe shfrytëzohet, po çon në kolaps të sistemit dhe në shkeljen e njëres nga të drejtat më themelore të njeriut të njohur ndërkombëtarish dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kështu, theksohet se përmirësimi i llogaridhënies dhe integritetit në kuadër të sistemit të drejtësisë duhet adresuar, dhe atë adresuar njëmend.

Kjo sipas këtij opsioni duhet bërë duke luftuar mangësitë në llogaridhënie dhe integritet në dy drejtimet, siç u tha më sipër, përmes: vetingut në njërën anë dhe ndryshimeve ligjore sa i përket disiplinimit dhe vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës, në anën tjetër.

4.3.1 Veting

Kujtojmë se ky Raport përcakton vetëm një identifikim të modaliteteve dhe skenarëve të mundshëm që kanë të bëjnë me ngritjen e llogaridhënies së sistemit të drejtësisë dhe nuk përbën një analizë të thukët se si opsionet e paraqitura duhen zbatuar dhe do duken hollësisht në praktikë.

Megjithatë, theksohet se ndonëse opsioni në fjalë, flet për themelimin e mekanizmit të vetingut, ajo çka ky opsion çon përpara duhet distancuar nga modeli i vetingut që ka ndodhur në Kosovë në 2010-tën apo edhe modeli i vetingut në Shqipëri. Kjo për faktin se qëllimi madhor është që të arrihet integriteti i vazhdueshëm i atyre që vënë drejtësisë dhe jo që ky kontrollim të përcaktoj 'pastërtinë e sistemit në një moment të caktuar në kohë'.

Nevoja për analizë shtesë nuk e minimizon paraqitjen e disa çështjeve në formën e konceptit ideor, si më poshtë, lidhur me atë se çfarë është e rëndësishme të merret parasysh dhe nuk duhet neglizhuar me rastin e projektimit, normimit dhe zbatimit të vetingut, të cilat çështje janë po nuk kufizohen në:

1. **Qëllimi i vetingut** – të pasurit e një sistemi të drejtësisë që është i drejtë, vërtetë i paanshëm dhe i pavarur, ku respektohet e drejta e qytetarëve të Kosovës në gjykim të drejtë, tek i cili kanë besim qytetarët dhe i cili do mbajë me seriozitet përgjegjësi të gjithë ata që bien ndesh me ligjin. Rikujtohet se Kushtetuta e Republikës shpreh decidivisht se gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni,

kur të kenë shkelur ligjin me qëllim dhe se Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe duhet të veprojë në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Vetingu kështu siç është paraqitur në këtë opsion, ka synim që të avancoj realitetin e sistemit të drejtësisë në idealet që parasheh Kushtetuta.

2. **Çfarë do të thotë veting?** - Për nevojat e këtij opsioni, **vetingu** nënkupton **kontrollin e vazhdueshëm të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve** me qëllim që të vlerësohet dhe garantohet përshtatshmëria e tyre për të qenë pjesë e sistemit. Vetingu nuk ndërthet në vetvete edhe kontrollin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve përveç rasteve kur performanca e tyre e dobët është indikator i integritetit të cenuar apo të cenueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
3. **Ndryshimet në Kushtetutë apo legjislacion për të akomoduar vetingun** - Duhet bërë një analizë shtesë të thukët dhe profesionale për të vlerësuar ndryshimet në legjislacionin vendor që i implikon zhvillimi i procesit të *vetingut*, përkatësisht, nëse duhet shkuar me ndryshime të Kushtetutës së Republikës së Kosovës apo nëse në fakt ka hapësirë ligjore që vetingu të zhvillohet vetëm përmes ndryshimit apo hartimit të ligjeve. Rikujtojmë se Kushtetuta parasheh se gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni edhe për mosrespektimin e rëndë të detyrave. Duhet sqaruar nëse integriteti i munguar hyn në kuadër të kësaj kategorie, dhe varësisht nga kjo të jepet zgjidhja se a duhet ndryshuar Kushtetuta apo të adresohet çështja vetëm me ligj. Po ashtu duhet pasur parasysh se kjo formë e vetingut për përshtatshmërinë apo mos përshtatshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve i lë vendimmarrës KGjK-në dhe KPK-në dhe Presidentin e Republikës së Kosovës, skenar i cili konsiderohet se është në përputhshmëri me Kushtetutën;
4. **Hartimi i Ligjit për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve**⁷³ – Ky ligj do jetë voluminoz dhe do parasheh të gjitha modalitetet, përveç ato të rëndësisë dytësore, që kanë të bëjnë me kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të paraqitura në këtë opsion dhe jo vetëm, duke shmangur sa më shumë që është e mundur normimin e çështjeve të rëndësishme me akte nënligjore;
5. **Përcaktimi i autoritetit i cili zhvillon procesin e vetingut** - Të themelohet një organ i pavarur (*tutje*: Autoriteti përgjegjës),⁷⁴ profesionalist dhe i përbërë nga persona me integritet. Mund të merret shembull autoritetet për vetingun në shtetet e tjera, me theks të veçantë në ato me demokraci të brishtë, si dhe kriteret për përzgjedhjen e tyre por duke evituar mangësitë e identifikuara. Ndërkombëtarët do

⁷³ Ligji mund të ketë tjetër emërtim por i cili do rregulloj të njëjtën materie.

⁷⁴ Mandati i anëtarëve të Autoritetit përgjegjës t'i lihet një analize nga Grupi tjetër Punues, duke marrë parasysh edhe që këta anëtarë duhet t'i nënshtrohen procesit të Vetingut

kenë vetëm rol monitorues dhe këshillëdhënës dhe kjo në raundet e para të zhvillimit të vetingut. Autoriteti përgjegjës do zhvilloj kontrollin e vazhdueshëm të integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndërkaq vendimi i lihet KGJK respektivisht KPK-së, lidhur me përshtatshmërinë apo mos përshtatshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të 'verifikuar' për të ushtruar tutje funksionet e tyre. Me të drejtë, për këtë vendim duhet merren parasysh të gjeturat e Autoritetit përgjegjës.

6. **Të përcaktohet përbërja, emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Autoritetit përgjegjës:** Për këtë duhet po ashtu zhvilluar një analizë e thellë dhe profesionale, duke shikuar edhe praktikën dhe rezultatet në shtetet e tjera në përputhje me standardet ndërkombëtare.
7. **Veting për anëtarët e autoritetit përgjegjës** – edhe anëtarët e Autoritetit përgjegjës duhet t'i nënshtrohen vetingut të vazhdueshëm. Modalitetet lidhur me atë se kush dhe si do e zhvilloj vetingun ndaj tyre duhen analizuar tutje, mirëpo e rëndësishme është që ky proces të jetë shumë rigoroz dhe të mos lihet vend për ndikime.
8. **Garantimi i resurseve të mjaftueshme për autoritetin përgjegjës** – Autoriteti përgjegjës duhet të ketë pavarësi buxhetore. Kjo në mënyrë që ta kryej punën në mënyrë sa më të pavarur, paanshme, efikase dhe produktive. Shpenzimet e Autoritetit përgjegjës i nënshtrohen auditimit.
9. **Rekomandimet me konkluzat rreth mos/përshtatshmërisë** – Autoriteti përgjegjës të gjeturat nga procesi i vlerësimit të integritetit i paraqet me shkrim, në formë të Rekomandimit të arsyetuar mirë pranë KGJK-së respektivisht KPK-së. Ky propozim është përshtatshëm i ngjashëm me normimin kushtetues ndaj vetingut të vitit 2010 në Kosovë, i shfuqizuar tashmë.⁷⁵
10. **Vendimi mbi përshtatshmërinë apo mos përshtatshmërinë** –KGJK dhe KPK duke u shërbyer me të gjeturat nga rekomandimet e Autoritetit përgjegjës, marrin vendimin, përkitazi me faktet, mbi përshtatshmërinë apo mos përshtatshmërinë e gjyqtarëve respektivisht prokurorëve;
11. **Përcaktimi i të drejtës në ankesë** – subjektit të kontrollit të integritetit duhet ti lihet medoemos e drejta në ankesë. Kjo mund të bëhet qoftë në fazën e draftimit të rekomandimit, para se ai të dërgohet tek KGJK respektivisht KPK, ose pasi këto të fundit kanë marrë vendimin mbi përshtatshmërinë apo mos përshtatshmërinë. Për caktimin e instancës e cila bën shqyrtimin e ankesës mund të konsultohet Kushtetuta ku sipas nenit 104, paragrafi 5, ku parashihet që gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen

⁷⁵ Kushtetuta, neni 150, paragrafi 3.

ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ndërkaq, Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh se kujt i drejtohen me ankesë prokurorët në rast të shkarkimit të tyre nga pozita prokuroriale. Ndaj për prokurorët duhet elaboruar legjislacioni në fuqi dhe të bëhet zgjedhja më e mirë, apo të veprohet në analogji me rregullimin për gjyqtarët për të mos pasur dallim mes ankimimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

12. **Shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve pa integritet** - Në rast se gjyqtari apo prokurori rezulton i pa përshtatshëm për të ushtruar funksionin që ka, atëherë KGJK respektivisht KPK i propozon Presidentit të Shtetit shkarkimin e tyre ashtu siç parasheh edhe Kushtetuta.
13. **Procesi i vetingut duhet kuptuar si i ndarë nga procedura penale** – konstatimi mbi mospërshtatshmërinë nuk nënkupton automatikisht se i njëjti bëhet subjekt i ndjekjes penale;
14. **Ndalimi i ushtrimit të funksioneve brenda sistemit të drejtësisë** - personi që nuk kalon procesin e vlerësimit të integritetit nuk do ketë mundësi që të jetë prapë pjesë e sistemit të drejtësisë;
15. **Identifikimi i momenteve kur duhet nënshtruar vetingut** - veting duhet të zhvillohet në rastet e përcaktuara si vijon:
 - a) rekrutimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë;
 - b) me rastin e avancimeve;
 - c) si dhe vetingut periodik;
16. **Përcaktimin se në çfarë periudha kohore zhvillohet vetingu periodik** – vetingu duhet zhvilluar në periudha kohore që nuk janë as shumë të shkurta që të komprometojnë procesin efektiv dhe serioz të vetingut i cili merr mjaftë kohë dhe resurse, e as në periudha kohore shumë të gjata që do zbehte edhe kuptimin e zhvillimit të vetingut. Idealisht vetingu periodik duhet zhvilluar çdo 5 vite. Për raundin e parë, duhet parashihet që pozitat më të larta përbrenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përkatësisht ato menaxheriale dhe ato të gjykatave dhe prokurorive të instancave më të larta duhet të i nënshtrohen më së pari vetingut. Po ashtu për raundin e parë të vetingut duhet zhvilluar short për të përcaktuar se kush në kuadër të gjyqtarëve dhe prokurorëve do jetë objekt i vlerësimit në secilin vit kalendarik për pesë vitet e para të funksionimit të procesit të vetingut, kurse pas përfundimit të kësaj periudhe vetingu zhvillohet 5 vite nga vetingu i fundit për secilin gjyqtarë dhe prokurorë.
17. **Përcaktimi i kategorive që i nënshtrohen vetingut** – ajo çfarë është e pa kontestueshme është që procesit të vetingut duhet ti nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që veprojnë përbrenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial në

Republikën e Kosovës. Vetingut duhen nënshtruar edhe stafi mbështetës i sistemit prokurorial dhe gjyqësor si kategori e veçantë e shërbyesve civil për shkak të ndjeshmërisë së punës së tyre. Po ashtu që në kuadër të një analize shtesë duhet vlerësuar nevoja që vetingut t'i nënshtrohen edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Policia e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera të ndjeshme.

18. **Çka është objekt i kontrollit të integritetit** – kontrolli i integritetit trajton përshtatshmërinë ose mos përshtatshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, duke vlerësuar një mori elementesh. Këto elemente përfshijnë por nuk kufizohen në: integritetin moral, personal, cënueshmërinë ndaj korrupsionit dhe veprave të tjera në kundërshtim me ligjin dhe parimet e sistemit të cilit i përket, çështjet e shëndetit mendor, dyshimet e ngritura për kontakte të afërta me persona të papërshtatshëm⁷⁶, dilemat e ngritura financiare dhe pronësore, varshmëria ndaj substancave të dëmshme, etj.
19. **Të përcaktohen mjetet/burimet e kontrollit e integritetit** – të përcaktohen cilat baza të dhënave, cilat raporte dhe informacione duhen konsultuar dhe nga cilët akterë të kërkohen të dhëna;
20. **Të parashihet struktura ligjore, modalitetet rreth mekanizmit dhe procedura e vetingut të stafit mbështetës;**
21. **Të parashihet një përshkrim i hollësishëm i procedurës kontrollit të integritetit** – kjo kryesisht përmes Ligjit për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve por edhe akteve nënligjore derivuese;
22. **Të sigurohet që proceset e vetingut të jenë të drejta, objektive, dhe të respektojnë të drejtat e njeriut** – në projektimin e vetingut të marrin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, bota akademike, përfaqësues të sistemit të drejtësisë dhe akterë ndërkombëtarë si dhe të konsultohen parimet dhe standardet ndërkombëtare, praktikrat nga vendet tjera dhe për fund modeli i vetingut të jetë produkt i gjitha këtyre konsideratave;
23. **Kontrollimi se nuk çënohet pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve** - Projekt aktet ligjore të hartuara dhe ato për plotësim dhe ndryshim duhet të dërgohen për mendim në Komisionin e Venecias para se të procedohet me miratimin e tyre. Kjo do sigurojë që ndonëse ndërmerren veprime ligjore për të siguruar llogaridhënie në sistemin e drejtësisë në Kosovë, ato nuk çënojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të sistemit të drejtësisë;

⁷⁶ Definimi i këtij termi i lihet një analize më të thukët dhe profesionale ku ky person nënkupton por mund të mos kufizohet në persona të cilet kanë bërë shkelje të etikës dhe shkelje të tjera ligjore.

24. Çështje tjera të nevojshme.

4.3.2. Ndryshimet ligjore lidhur me vlerësimin e performancës dhe procedurën disiplinore

Ndonëse kontrolli i përhershëm i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është nevojë e padiskutueshme dhe masë e domosdoshme, për t'i shërbyer qëllimit të të pasurit një sistem të drejtësisë të drejtë, vërtetë të paanshëm, të pavarur dhe profesional, kontrolli i integritetit siç u tha më lartë nuk duhet shikuar si zgjidhje e izoluar.

Nuk ka kuptim të kemi gjyqtarë dhe prokurorë të pastër për nga integriteti nëse të njëjtit nuk bëjnë punë të mirë apo nuk vihen përgjegjës për gabimet që bëjnë gjatë ushtrimit të detyrës.

Vetëm me krijimin e hallkave të fuqishme të integritetit, performancës dhe disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe të tjerë akterëve të ndërlidhur (siç parashihet nevoja për analizë si më lartë), do arrihej që të kemi një sistem të drejtësisë të pathyeshëm dhe për rrjedhojë një shtet që mirë funksionon.

Kjo është edhe arsyeja përse segmenti i dytë i opsionit 4 është ndërmarrja e ndryshimeve ligjore për të fuqizuar dhe përmirësuar mekanizmat dhe procedurat e vlerësimit të performancës dhe procedurës disiplinore.

Ritheksohet fuqishëm që ky opsion nuk con në drejtim të ideve të prezantuara si zgjidhje të problemeve ekzistuese në opsionin 2 të këtij Raporti.

Po ashtu vlen të ceket se janë bërë disa përpjekje të izoluar për të përmirësuar procedurën e disiplinimit dhe performancës edhe së fundi⁷⁷, mirëpo prapë se prapë duhet bërë një analizë e thellë, profesionale dhe e hollësishme për të identifikuar nëse këto ndryshime kanë rezultuar vërtetë të suksesshme dhe nëse jo, të gjendet zgjidhje për përmirësim të këtyre mekanizmave.

Në kuadër të këtij opsioni nuk do ofrohen zgjidhje konkrete, pasi kjo i lihet një analize më të thuktë dhe me resurse më të mëdha njerëzore, thjeshtë bëhet një skanim i gjendjes dhe nevojës për ndryshim.

a) Performanca:

a. Mekanizmat ekzistues të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në raportimet e shumta vendore dhe nga akterët ndërkombëtar nuk janë në nivel të kënaqshmë. Nga këto raportime dhe statistikat në dispozicion del se ndonëse në realitet

⁷⁷ Për shembull së fundi nga KPK.

jemi dëshmitarë të një pune të dobët profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve mekanizmat e vlerësimit të performancës rrallë herë kanë vlerësuar dobët të njëjtit.

Theksohet se nëse nuk do ketë mekanizma dhe procedura produktive dhe të drejta për të vlerësuar se si performojnë gjyqtarët dhe prokurorët, atëherë nuk do ketë as shtytje për ata që të performojnë denjësisht gjatë punës së tyre.

Në këtë drejtim raportohet për numra alarmant të lëndëve të parashkruara qysh nga paslufta, pastaj mospërgatitje të duhur të akuzave, numër të lartë kur prokurorët kërkojnë shtyrjen e gjykimeve si pasojë e mospërgatitjes, shkelja e afateve procedural ligjore e shumë probleme të tjera.

Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve duhet të jetë i drejtë, të bëhet në mënyrë uniforme për të gjithë, të jetë cilësor, të zhvillohet në mënyrë transparente, të respektojnë të drejtën në ankesë dhe të drejtat e njeriut.

Në projektimin e mekanizmit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet marrë parasysh Rekomandimet Kyiv 2010, Mendimit të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë Nr.17 (2014) mbi vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësinë e drejtësisë si dhe respektimin e pavarësisë gjyqësore, si dhe parimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare.

Duhet të konsiderohet që matja e performancës të bëhet më shumë bazuar në kritere kualitative dhe jo kuantitative siç është bërë deri tani.

Tutje, performanca e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk duhet vlerësuar në mënyrë shabllone por të varet nga natyra e lëndëve të tyre dhe të tjerë faktor relevant. Po ashtu në rastin e pozitive menaxheriale, vlerësimi i performancës të jetë i veçantë dhe i përshtatshëm.

Për fund theksohet se procedura dhe mekanizmat e projektuar për zhvillimin e procedurës për vlerësimin e performancës për gjyqtarë dhe prokurorë duhen paraparë sa më shumë që është e mundur në kuadër të legjislacionit primar.

b) Disiplinimi

Ashtu siç është rregulluar tani procedura e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në shifrat e raportuara rezulton se procedura disiplinore nuk funksionon siç duhet. Janë të rralla rastet kur procedura disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë ka si produkt sanksionimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve e edhe atëherë kur shqiptohen masa ndaj atyre që rezultojnë se kanë kryer sjellje jo etike apo sjellje të keqe profesionale, masat e shqiptuara janë shumë të buta dhe që nuk stimulojnë kujdes më të madh ndaj thyerjes së rregullave.

Parë rezultatet tash e sa vjet nga një sistem i dobët i disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke pasur parasysh rëndësinë që ka disiplinimi, dhe po ashtu duke rikujtuar përpjekjet e ndryshme ndër vite për 'të gjetur' mekanizmat më efikas, konsiderohet se nuk duhet bërë vetëm disa ndryshime estetike në kuadër të procedurës disiplinore por duhet zhvilluar një analizë e thuktë dhe profesionale e cila ka si objektiv krijimin e një mekanizmi dhe procedure disiplinore ku prokurori dhe gjyqtari që ka bërë diçka të gabuar në fakt sanksionohet.

Në projektimin e një sistemi funksional, objektiv, produktiv dhe llogaridhënës të disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhen marrë parasysh parimet e përcaktuara evropiane dhe ndërkombëtare të tilla si: Mendimin e Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropian Nr. 14 (2018) "Pavarësia, llogaridhënia dhe etika e prokurorëve", Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës KM/Rek (2000)19, "Roli i Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale", Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës KM/Rek (2010)12, "Gjyqtarët: Pavarësia, Integriteti, dhe Përgjegjësitë, Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, Parimet e Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, etj.

Procedura disiplinore e projektuar duhet të siguroj transparencë, të jetë e drejtë, të sigurohet e drejta për tu dëgjuar, e drejta në ankesë, prezumimin e pafajësisë, të respektoj parimin e proporcionalitetit dhe të respektoj të drejtat e tjera të njeriut.

Për fund theksohet se, ngjashëm si për vlerësimin e performancës, procedura dhe mekanizmat e projektuar për zhvillimin e procedurës disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë duhen paraparë sa më shumë që është e mundur në kuadër të legjislacionit primar.

4.4 Opsioni IV - Vetingu

Procesi i skenimit, vlerësimit dhe verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve⁷⁸ (Tutje: *Vetingu*) paraqet reformën më të madhe në sistemin e drejtësisë. Vetingu është procesi përmes të cilit skenohet, vlerësohet dhe verifikohet integriteti, performanca, etika e gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë por pa u kufizuar në të kaluarën, pasurinë, lidhjet eventuale me politikën, grupet e interesit dhe karakteristika të tjera në kuadër të integritetit, performancës dhe etikës.

Ky proces, krahas të tjerave, është një proces i ndërlikuar për tu zbatuar në praktikë, për të cilën arsye, duhet të sigurohet mbrojtja e sigurisë juridike të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë drejtim është e domosdoshme të sigurohet baza ligjore dhe kushtetuese, në mënyrë që ky proces mos të zhvillohet “në tërësi” kushtetues dhe ligjor. Për më tepër, korniza ligjore e përcaktuar me amendament kushtetues dhe ligj të veçantë do të jetë mburojë dhe garancë se të drejtat dhe liritë e garantuara për zyrtarët që do të nënshtrohen vetingut të mbrohen si në aspektin juridik ashtu dhe atë praktik.

Për më tepër, duhet të kihet parasysh edhe rreziku kundër produktiv që mund të vijë si pasojë, nëse ky proces nuk zhvillohet në përputhje me respektimin e të drejtave të njeriut. Një reformë rrënjësore në sistemin e drejtësisë si procesi i vetingut, duhet të arrijë që sistemin e drejtësisë ta kthejë në binarë, që i njëjti më pastaj të kontrollohet në mënyrë efektive nga ana e mekanizmave të brendshëm. Në të kundërtën, nëse ky proces nuk zhvillohet në mënyrë meritore, atëherë është rreziku që sistemi i drejtësisë të marrë kurajë për të mos u këndellur, nëse as procesi i vetingut nuk rezulton i suksesshëm. Vetingu mbi të gjitha do ta kthente besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Për këto arsye, në vijim të këtij dokumenti janë paraqitur disa prej parimeve themelore mbi të cilat duhet të bazohet Qeveria nëse përcaktohet për këtë modalitet. Para përcaktimit të këtyre parimeve, fillimisht në këtë dokument janë paraqitur arsyet që ndërtojnë domosdoshmërinë e zhvillimit të procesit të vetingut në Republikën e Kosovës.

4.4.1 Paracaktimi i objektivave të procesit të Vetingut

Në këtë pjesë të dokumentit do të paraqiten objektivave të cilat synohet të arrihen pas zhvillimit të suksesshëm të procesit të vetingut.

Objektivat e synuara përmes procesit të vetingut duhet të jenë negacion i të metave të sistemit të drejtësisë, të cilat të meta nuk mund të adresohen në situatën aktuale apo përmes ndryshimeve të caktuara ligjore. Për më tepër, këto qëllime do të trasojnë rrugën e ndërtimit

⁷⁸Shënim: Ky emërim ka karakter praktik, dhe jo domosdoshmërisht reflekton qëndrimin për emërtimin përfundimtar të procesit.

të komplet infrastrukturës ligjore për zhvillimin e këtij procesi, si dhe të njëjtat do të jenë edhe orientim i zhvillimit në praktikë të procesit të vetingut.

Në këtë drejtim, grupi punuese konsideron se qëllimet e paracaktuara të cilat synohet të arrihen përmes procesit të vetingut duhet të jenë:

1. Depolitizimi i sistemit të drejtësisë
2. De influencimi i sistemit të drejtësisë nga grupet e interesit
3. Fuqizimi i sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës
4. Ngritja e cilësisë profesionale të sistemit të drejtësisë
5. Ngritja e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë
6. Ngritja e rezultateve dhe performancës kualitative në sistemin e drejtësisë
7. Ngritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë
8. Ngritja e transparencës në sistemin e drejtësisë
9. Fuqizimi i mekanizmave të brendshëm të vetëkontrollit në sistemin e drejtësisë
10. Arritja e një drejtësie efikase dhe efektive, ku të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Mbrojtja e sigurisë juridike të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Domosdoshmëria e procesit të vetingut në asnjë rrethanë nuk nënkupton mungesën e personave profesional dhe me integritet në sistemin e drejtësisë. Për bindjen e grupit punues, kuadrot me integritet dhe profesionalizëm përballën me pengesa për të vepruar sipas ligjit në një sistem të ndikuar politikisht dhe të influencuar nga grupet e interesit. Kjo reflekton edhe më shumë nevojën se një sistem i vetingut mund të arrij qëllimin që të mbaj në sistem të drejtësisë kuadrot profesionale dhe tu krijoj hapësirë atyre pa pengesa që sistemit të drejtësisë ti japin nivelin e kërkuar profesional.

Në këtë drejtim, si këta akterë, por edhe ana tjetër e akterëve të sistemit të drejtësisë, duhet të kenë siguri juridike, në kuptim të mbrojtjes së tyre përmes një procesi të drejtë, të bazuar ekskluzivisht në kushtetutë dhe ligj dhe një procesi plotësisht transparent.

Për këtë arsye, ky grup punues nënvizon faktin se për tu arritur ky qëllim, ligji do të përmbajë në mënyrë eksplicite fushat për të cilat do të skanohen/vlerësohet/verifikohet secili gjyqtarë dhe prokurorë.

Krahas fushave, në mënyrë që secili gjyqtar dhe prokuror të mbrohet nga çdo arbitraritet eventual, por edhe për ngritjen e besimit të publikut në këtë proces, për secilën fushë, vetë ligji do të përmbajë edhe indikatorët specifik për vlerësimin e secilës fushë, të cilët indikatorë do të jenë të shumtë në numër, por shumë të ngushtë sa i përket gamës së përfshirjes.

Përcaktimi parimor i kësaj çështje në këtë dokument, krahas ngritjes së sigurisë juridike të gjyqtarëve dhe prokurorëve, do të ndikojë edhe në efikasitetin dhe cilësinë e ndërtimit të infrastrukturës ligjore mbi procesin e vetingut.

Gjatë hartimit të ligjit Qeveria duhet të ketë parasysh edhe një sërë çështjes tjera të nënkuptueshme të cilat duhet të adresohen në Ligjin për Vetingun si rrjedhojë e nevojës së garantimit të një procesi të drejtë dhe transparent, të cilat për shkak të nën kuptueshmërisë së tyre, nuk e kanë vendin në këtë dokument, por do ta kenë vendin në ligj (dyshkallshmëria, e drejta e prezantimit të fakteve dhe provave nga gjyqtari/prokurori etj), pastaj përcaktimi i afateve dhe dorëzimi i dëshmimeve nga palët e interesuara etj.

Përfshirja e ndërkombëtarëve në procesin e vetingut

Për të zhvilluar një proces të rregullt dhe të drejtë të vetingut, nëpërmjet të cilit do të arriheshin qëllimet e paracaktuara të këtij procesi, garantimi i këtij procesi duhet të bëhet përmes përfshirjes së faktorit ndërkombëtar në këtë proces përmes asistencës së përcaktuar paraprakisht.

Organizatave shoqërisë civile vazhdimisht kanë kërkuar zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë, dhe vazhdimisht kanë kërkuar që ky proces të bëhet me ndihmën dhe bashkëpunimin e plotë të faktorit ndërkombëtar.

Një përfshirje e tillë e faktorit ndërkombëtar është e domosdoshme, pasi nuk ka arsyeshmëri që të ketë ristrukturim të mekanizmave ekzistues deri më tani, në një proces të jashtëzakonshëm, i cili tenton që të këndell sistemin e drejtësisë, në mënyrë që i njëjti të ketë mundësi të funksionojë sipas mekanizmave tanimë të fuqishëm të vetë kontrollit.

Andaj, përfshirja e faktorit ndërkombëtar në këtë proces duhet të jetë njëri ndër parimet kryesore që udhëheq gjithë procesin, i cili në këtë dokument, duhet të paraqitet si element i domosdoshëm dhe i cili duhet të përfshihet në materien e gjithë infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë. Roli i ndërkombëtarëve në këtë proces duhet të lihet në dy drejtime, në atë të monitorimit të gjithë procesit dhe në atë të këshillëdhënësit për gjatë gjithë procesit.

Qasja gjithëpërfshirëse në zhvillimin e procesit të vetingut

Zhvillimi i procesit të vetingut në mënyrë të drejtë dhe profesionale, i cili proces synon rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, domosdoshmërisht se duhet të ketë qasje gjithëpërfshirëse.

Në këtë drejtim, kjo gjithë përfshirje duhet të reflektohet si në draftimin e infrastrukturës ligjore, ashtu edhe në zhvillimin në praktik të këtij procesi.

Pjesa më e rëndësishme e kësaj qasje duhet të jetë përbërja e komisioneve vlerësuese për gjyqtarë dhe prokurorë.

Në këtë rast, të dy komisionet, ai i shkallës së parë dhe shkallës së dytë, mund të kenë një përfaqësim gjithëpërfshirës, në përbërjen e të cilave duhet të ketë gjyqtarë, prokurorë, profesor universitar, ekspert të pavarur, përfaqësues nga shoqëria civile dhe përfaqësues nga faktori ndërkombëtar.

Për më tepër, Ligji për Vetingun duhet të përcaktojë se të gjithë anëtarët e të dy komisioneve, kompensimin për punën e tyre do ta pranojnë nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Në mënyrë parimore, kjo qasje gjithëpërfshirëse reflektohet në këtë dokument, dhe më pastaj do të përcaktohet edhe në ndryshimet kushtetuese dhe detajizimi do të bëhet në Ligjin për Vetingun.

Konsensusi politik dhe domosdoshmëria e plotësimit ligjor-kushtetues

Zhvillimi i një procesi madhor dhe të rëndësishëm si procesi i vetingut, kërkon edhe një konsensus politik, i cili në aspektin e vendimmarrjes, manifestohet veçanërisht në domosdoshmërinë që ky proces të zhvillohet përmes ndryshimeve kushtetuese.

Për më tepër, neni 144.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se *“Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”*. Për këtë arsye, konsensusi politik duhet të shtrihet edhe në nivel të komuniteteve që mbajnë vende të garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pa të cilin konsensus, nuk mund të funksionalizohet, e rrjedhimisht as të zhvillohet, ky proces.

4.4.2 Modeli i Vettingut

Sa i përket procesit të vetingut, përcaktimi i modelit të tij apo gamës së akterëve të sistemit të drejtësisë të cilët do të nënshtrohen procesit të vetingut është çështje e domosdoshme.

Ky grup punues, do të paraqes një model, në këtë dokument, dhe zgjedhja e këtij modeli të vetingut, do të varet nga vullneti politik. Por se, në këtë dokument, grupi punues do të sqarojë modelin, me ç’rast do të përcaktojë edhe përparësitë dhe mangësitë e tij.

Modeli i vetingut është një proces i verifikimit dhe vlerësimit të secilit gjyqtarë, prokurorë dhe Drejtorët e Sekretariateve të Këshillave.

Ky model i vetingut shtrihet në gjithë akterët e sistemit të drejtësisë, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, pa marrë parasysh nëse i njëjti akter ka ose jo ndonjë pozitë menaxheriale brenda sistemit të drejtësisë.

Vlerësimi dhe verifikimi i të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve, benefiti kryesor ka verifikimin e të gjithë akterëve të sistemit të drejtësisë si dhe vlerësimin e secilit, me ç'rast kthehet besimi i qytetarëve tek gjyqësori. Në këtë mënyrë, verifikohet dhe vlerësohet secili gjyqtarë dhe prokurorë dhe pas përfundimit të këtij procesi, sistemi i drejtësisë përbëhet vetëm nga akterë të cilët e kanë kaluar procesin e vetingut.

Por, sa i përket këtij modeli, zbatimi i të njëjtit ka edhe një kosto bukur të lartë kjo pasi ky model kërkon kohë më të madhe për zhvillimin e procesit të vetingut, për të cilën arsye, afekton shumë më shumë aktivitetin e sistemit të drejtësisë, i cili afektim ka një impakt direkt në rritjen e numrit të lëndëve të pazgjdhura dhe rrjedhimisht, zvarritjen e lëndëve që sistemi i drejtësisë ka në punë.

Për këtë arsye, në këtë model, kërkohet që krahas zhvillimit të procesit të vetingut, varësisht nga fazat të cilat do të shpjegohen në tabelën më poshtë, të shpallet konkurs për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët në numër do të inkuadrohen në sistemin e drejtësisë, varësisht numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk e kalojnë procesin e vetingut.

Ndryshimet kushtetuese

Procesi i vetingut nuk paraqet një vlerësim dhe verifikim të rregullt të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe ky proces, nuk paraqet ristrukturim të mekanizmave aktual për vlerësimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në materien e saj aktuale nuk lë hapësirë për një shmangie procedurale të vlerësimin dhe verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo thënë më ndryshe, nuk jep mundësi për një verifikim të jashtëzakonshëm, pasi përcakton vetëm vlerësimin dhe verifikimin e rregullt të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili bëhet nga KGJK dhe KPK. Përkatësisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës kufizohet vetëm në mekanizmat aktual të vetë kontrollit të sistemit të drejtësisë, që rrjedhimisht, nuk lejon zhvillimin e procesit të vetingut.

Krahas kësaj, në mënyrë që procesi i vetingut të garantojë sigurimin maksimal të sigurisë juridike dhe i njëjti proces të jetë efikas, përmbajtja e ligjit nuk duhet të kalojë përmes “tehut” ligjor, por se ky ligj dhe ky proces, duhet të ketë mbështetje dhe bazueshmëri të plotë kushtetuese. Për më tepër, inicimi i këtij procesi paraprakisht duke miratuar ndryshimet eventuale kushtetuese me amandamentet përkatëse, do të siguronte këtë proces nga çdo sabotim eventual pasues i këtij procesi, në kuptim të shfuqizimit të ligjit, apo një proces i cili ankimohet më pas në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye, një ndër parimet kryesore që

duhet të kihet parasysh gjatë ndërtimit të vetingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë, është që ky proces para së gjithash duhet të bëhet me ndryshime kushtetuese.

Miratimi i Ligjit për Vettingun

Krahas miratimit të ndryshimeve kushtetuese, për zhvillimin e procesit të vetingut është e domosdoshme edhe miratimi i Ligjit për Vettingun. Me këtë ligj, synohet që të përcaktohen qëllimet e këtij procesi, të bëhet funksionalizimi i komisioneve dhe procesit në tërësi si dhe të përcaktohen të gjitha procedurat për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Thënë më ndryshe, ky ligj në praktikë do të jetë baza kryesore ligjore për zhvillimin e procesit të vetingut ashtu siç është përcaktuar nga modaliteti IV i këtij grupi punues. Me këtë rast, është e rëndësishme që në këtë dokument të përcaktohet përgjithësisht qasja që duhet ndjekur me rastin e draftimit të Ligjit mbi Vettingun.

Në këtë drejtim, për të rritur sigurinë juridike dhe integritetin e gjithë procesit, është e rëndësishme që Ligji për Vettingun mos të ndjek qasjen që për një numër të konsiderueshëm të çështjeve, të përcaktojë se do të rregullohen me akte nënligjore.

Ligji për Vettingun duhet të përcaktojë të gjitha procedurat që nga fillimi e deri në përfundim të vlerësimit të një gjyqtari apo prokurori, duke përcaktuar po ashtu edhe afatet procedurale të secilit veprim. Ashtu siç është thënë paraprakisht, në këtë ligj duhet të përcaktohen edhe të gjitha fushat për të cilat do të vlerësohet secili gjyqtar dhe prokuror. Por, krahas fushave, është e rëndësishme që për secilën fushë, me ligj të përcaktohen edhe të gjithë indikatorët specifik, përmes të cilëve do të vlerësohet shkalla e vlerësimit për një fushë të caktuar. Një qasje e tillë e ligjit do të sigurojë sigurinë juridike të secilit gjyqtar dhe prokurorë që i nënshtrohet vlerësimit si dhe do të ngritë transparencën dhe besueshmërinë e publikut në procesin e vetingut.⁷⁹

Ndërsa, sa i përket akteve nënligjore, ky ligj duhet të jetë i kufizuar në çështjet që i lë në kompetencë rregullimi përmes akteve nënligjore kjo për shkak se degës së ekzekutivit përmes akteve nënligjore nuk mund ti krijohet asnjë hapësirë për të cenuar besueshmërinë e këtij procesi e as të tentoj të ushtroj ndonjë lloj ndikimi përmes akteve nënligjore të shpallura nga Qeveria, gjegjësisht Ministria e Drejtësisë. Në këtë drejtim, fushat për të cilat ligji do të përcaktonte se do të rregullohen me akte nënligjore duhet të jenë vetëm fusha me karakter teknik dhe administrativ, por të cilat nuk ndikojnë në materien e zhvillimit të procesit të vetingut.

Dispozitat e veçanta mbi efikasitetin

⁷⁹ Me rastin e draftimit të infrastrukturës ligjore, duhet të trajtohet çështja e gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë në prag të pensionimit dhe atyre që do ofrojnë dorëheqjen pa ju nënshtroar procesit të vetingut.

Procesi i vettingut do të zhvillohet edhe gjatë kohës kur kërkohet zhvillimi i aktivitetit të sistemit të drejtësisë, për të cilën arsye, zhvillimi i këtij proces, domosdoshmërisht se afekton edhe aktivitetin e sistemit të drejtësisë.

Me qëllim që efektet negative në aktivitetin e sistemit të drejtësisë të minimizohen, është e rëndësishme që korniza ligjore të përcaktojë në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat, dhe për secilin veprim procedural, të përcaktojë edhe afatet ligjore.

Në këtë drejtim, afatet ligjore nuk duhet të jenë në dëm të cilësisë së procesit të vettingut, por prapë se prapë, duhet të jenë afate që garantojnë efikasitetin e zhvillimit të procesit të vettingut.

Për më tepër, përcaktimi i afateve ligjore për secilin veprim procedural e bënë të mundur edhe parashikueshmërinë e procesit të vettingut dhe si rrjedhojë, edhe identifikon masat e nevojshme për ruajtjen e gjendjes në sistemin e drejtësisë.

Ky grup propozon që afatet ligjore për realizimin e procesit të vettingut të jenë si më poshtë në vijim:

Fazat dhe koha e realizimit dhe përmbylljes së procesit të vettingut

Tërë procesi i vettingut, do të duhej të realizohej përmbyllet për periudhën 5 vjeçare. Procesi i tillë do të përfshinte aktivitete të cilat ndërlidhen me ndryshimet e nevojshme ligjore dhe kushtetuese, formimin e trupave vlerësuese të cilat do ta realizonin procesin e vettingut bazuar në ndryshimet e nevojshme ligjore dhe kushtetuese dhe dokumentet dhe planet e punës së komisionit. Në tabelën në vijim janë paraqitur aktivitetet dhe koha e nevojshme për realizimin dhe përmbylljen e procesit të vettingut.

Procesi i Vettingut në Republikën e Kosovës

Aktivitetet	Koha sipas muajve (total 60 muaj; #6 muaj)									
	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj
Kompletimi i ndryshimeve kushtetuese/ligjore (Ligji për Vetting)	X	X								
Themelimi i komisioneve të Vetting-ut		X								
Dokumenti strategjik dhe plani i punës për Vetting i Komisionit		X								
Faza e parë e Vetting (kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët dhe KGjK/KPK)			X	X						
Kompletimi i pozitave vakante nga faza 1					X					
Faza e dytë e Vetting (gjykatësit dhe prokurorët e nivelit suprem, apel dhe themelor)						X	X	X		
Kompletimi i pozitave vakante nga faza 2									X	X
Vlerësimi final i tërë procesit										X (3 muaj)

Sipas pasqyrimit në tabelë, tre aktivitetet e para të cilat do të duhej të kompletoheshin për periudhën një vjeçare, janë miratimi i ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore, themelimi i komisioneve/trupave të cilat do ta realizonin vetting-un si dhe përpilimi i një

dokumenti strategjik dhe planit të punës së vet komisionit në bazë të të cilit ky komision do ta realizonte vetting-un.

Faza e parë e Vetting e cila do të përfshinte verifikimin dhe vlerësimin e të gjithë kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve, kryesuesve dhe anëtarëve të KGJK dhe KPK-së do të realizohet në afatin prej një viti. Plotësimi i pozitave eventuale vakante nga faza e parë, do të bëhej në periudhën prej 6 muajve pas përfundimit të fazës së parë.

Faza e dytë e vetting-ut do të përfshinte verifikimin/vlerësimin e të gjithë gjykatësve dhe prokurorëve, duke filluar nga niveli suprem, ai i apelit si dhe niveli themelor, do të zbatohet për periudhën prej 1 viti e gjysme, e cila do të pasohej nga periudha nëntë mujore e plotësimi të pozitave vakante të dala nga faza e dytë.

Dhe aktiviteti i fundit do të ishte vlerësimi final i procesit të vettingut, i cili do të përfshinte vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha aktiviteteve të përfshira dhe përmbyllura në periudhën 5 vjeçare.

4.4.3 Domosdoshmëria e procesit të vettingut

Reforma më e madhe në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës është bërë më 1 janar 2013, kur edhe ka hyrë në fuqi Kodi i ri Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji për Gjykatat. Sipas këtij të fundit, sistemi gjyqësor ka ndryshuar edhe për nga aspekti i funksionimit, i cili organizim, tentoi që të siguronte efikasitet dhe efektivitet në drejtësinë në Kosovë. Paraprakisht, para kësaj date kanë hyrë në fuqi Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Po ashtu, gjykatat janë liruar nga një numër i madh i lëndëve siç janë rastet e përmbarimit të cilat trajtohen nga përmbaruesit privat dhe të njëjtat mund të vendosen nga gjykatat vetëm pas prapësimit të urdhrit përmbarimor nga debitori përkatës. Ky sistem megjithatë ka mundësuar që një numër i lëndëve të përmbarimit të mos trajtohen nga gjykatat meqë palët i përmbahen urdhrit përmbarimor pa ushtruar prapësim. Nga viti 2009 në Republikën e Kosovës është funksionalizuar sistemi i ndërmjetësimit me hapjen e qendrave të para të ndërmjetësimit që po ashtu kanë lehtësuar zvogëlimin e lëndëve dhe shkarkimin e gjykatave nga çështjet të cilat palët mund ti zgjedhin përmes ndërmjetësimit. Në vitin 2019 ligji për ndërmjetësim ka pësuar ndryshime dhe po ashtu ka përfshirë edhe sistemin e ndërmjetësimit të detyrueshëm si një sistem i ri në Kosovë. Kjo nënkupton se një numër i rasteve detyrimisht duhet të ndërmjetësohet, ose të tentohet të ndërmjetësohet para se të iniciohet procedurë gjyqësore. Deri sa ndërmjetësimi është treguar efikas, rastet e arbitrazhit vendor kanë qenë të pakta. Përveç këtyre, sistemi noterial nga viti 2012 po ashtu ka lehtësuar punën sidomos të administratës së gjykatave duke qenë se numri i madh i veprimeve që janë bërë pranë gjykatave në kuptim të vërtetimit dhe autenticitetit tani më kryhen pranë zyrave noteriale.

Por, përkundër kësaj reforme, ndryshimeve ligjore dhe krijimeve të mekanizmave komplementar, adresimi i sfidave të sistemit të drejtësisë nuk ishte bërë në nivelin e synuar, për të cilën arsye, është shtruar nevoja e një reforme më rrënjësore se sa reformat paraprake.

Raportet vendore dhe ndërkombëtare mbi hulumtimin e opinionit të qytetarëve rreth besueshmërisë ndaj institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale ndër vite janë ndër më të ulëtat. Sa i përket besimit të qytetarëve për përfshirje në korrupsion, ata deklarohen se gjyqësori dhe prokuroria janë në përqindje shumë të madhe të përfshirë në korrupsion⁸⁰.

Ndërkaq, nga ana tjetër Raportet e progresit të Kosovës të realizuara nga BE, përfshirë edhe Raportin për vitin 2020, theksojnë faktin se drejtësia kosovare është akoma e ndikuar nga politika.

Mosndëshkimi i veprimtarive të korrupsionit, përmes aktgjykimeve dënuese të formës së prerë, sidomos të profilit të lartë, ashtu siç është adresuar përbrenda këtij raporti tek kapitulli i sfidave, jep përshtypjen për amnistinë që në raste jo të rralla iu bëhet politikanëve të korruptuar dhe zyrtarëve të profilit të lartë.

Për më tepër, në burgjet e Kosovës, ende nuk vuan dënim me burgim efektiv asnjë zyrtar i profilit të lartë për shkak të dënimit me aktgjykim të formës së prerë për korrupsion. Mungesa e respektimit të sundimit të ligjit, korrupsioni i nivelit të lartë dhe pasurimi i shpejtë i zyrtarëve të lartë, shkalla e madhe e papunësisë, mungesa e investimeve të huaja, besueshmëria e ulët e qytetarëve në institucione të drejtësisë, dëshmon se sistemi i drejtësisë i ndikuar skajshmërisht nga politika dhe grupet e interesit, bashkëjeton me veprimtaritë e tilla të politikës dhe grupeve të interesit, duke mos i ndjekur dhe gjykuar ato.

Për më tepër, në *“Javën Kundër Korrupsion”*, të mbajtur në dhjetor të vitit 2018, organizatat e shoqërisë civile⁸¹ kishin paraqitur një raport, në të cilin ishin paraqitur një mori rastesh të cilat pasqyronin nevojën e një reforme të thellë në sistemin e drejtësisë, që konsiston në nevojën për zhvillimin e një procesi të vetingut në sistemin e drejtësisë⁸².

Në vende në të cilat sistemi i drejtësisë garanton sundim të ligjit, nuk mohohen devijime potenciale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por, këto devijime, në asnjë rrethanë nuk e zbehin

⁸⁰ “Pulsi Publik IV”. Qershor 2018. USAID&UNDP. Sipas këtij raporti vetëm 31.2% shprehen të kënaqur me punën e gjykatave. Edhe më pak shprehen të kënaqur me punën e prokurorive, përkatësisht vetëm 29.9%. Më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar, besojnë se vendimet e gjyqësorit nuk janë të pavarura, përkatësisht vetëm 43.6% besojnë se ata janë të pavarur. Sa i përket korrupsionit, qytetarët besojnë se gjyqësori në masë të madhe është i përfshirë në korrupsion. Sipas anketës, në tetor 2016 rezultoi se 49.3% e qytetarëve kanë besuar se gjyqësori ishte i përfshirë në korrupsion, në të njëjtën periudhë pas një viti (në tetor 2017) 24.9% e qytetarëve kanë besuar se gjyqësori ishin të përfshirë në korrupsion, ndërsa në prill 2018 kjo përqindje është rritur, ku 38.6% e qytetarëve besojnë se gjyqësori është i përfshirë në korrupsion.

⁸¹“Vetingu pa alternativë”. IKD dhe Columbus. Dhjetor 2018. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/01/3.-Vetingu-pa-alternative.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 25 maj 2020).

⁸² Po aty.

suksesin e një sistemi të drejtësisë. Kjo pasi këto devijime, adresohen nga mekanizmat e vetëkontrollit dhe në secilin rast, sistemi kthehet në binarë.

Pra, sistemi i drejtësisë, përkundër disa përmirësimeve të identifikuar⁸³, karakterizohet me probleme në integritet dhe performancë të gjykatësve dhe prokurorëve për shkak të mungesës së funksionimit të mjaftueshëm të mekanizmave disiplinorë dhe atyre të performancës në kuadër të KGjK-së dhe KPK-së.

Problemet me integritet dhe llogaridhënie të prokurorëve dhe gjykatësve, kanë qenë ndër sfidat dhe problemet kryesore të cilat pamundësojnë tutje performancën kualitative të tyre drejtë një sistemi të pavarur dhe profesional të drejtësisë. Raste të konfliktit të interesit në sistemin e drejtësisë, pretendimet për kontakte të disa gjykatësve dhe prokurorëve me grupe të ndryshme të interesit, pastaj ndikimet politike në sistemin e drejtësisë të konstatuara edhe në raporte ndërkombëtare si dhe problemet profesionale (mos-përgatitja e prokurorëve në përfaqësim të aktakuzave, mos-ndëshkueshmëria në veçanti e profileve të larta), janë disa prej problemeve bazike të cilat shtrojnë nevojën e një verifikimi dhe vlerësimi – vettingu për gjykatës, prokurorë si dhe vet KGjK-së dhe KPK-së.

Reagimi i fundit i ambasadës amerikane⁸⁴ dhe Bashkimit Evropian dhe paralajmërimet e tyre për mospjesëmarrje në monitorimin e procesit të zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së dhe procesit të përzgjedhjes së kryeprokurorëve në prokuroritë përkatëse, përveçse shpërfaqë zhgënjimin e tyre përkundër investimeve dhe mbështetjes së gjatë, alarmon edhe për gjendjen e “prishur” në sistem siç ata e kanë vlerësuar dhe gjithashtu, thekson domosdoshmërinë e përfundimit të reformave kualitative në drejtësi.

Përgjatë të gjitha këtyre dështimeve, sistemi gjyqësor dhe prokurorial kanë poseduar me mekanizmat e vetë kontrollit, përkatësisht Komisionet Disiplinore dhe Komisionet për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve/Prokurorëve. Për më tepër, sistemi i disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe është e reformuar, deri sa kjo nuk është bërë me sistemin e vlerësimit të performancës. Por, deri më tani, këta mekanizma nuk kanë arritur që të evitojnë këto devijime të sistemit të drejtësisë, e cila heshtje e mekanizmave të brendshëm, i ka imunizuar gjyqtarët dhe prokurorët ndaj secilës shkelje, duke e shkatërruar

⁸³ Shih për shembull: “Raporti i Progresit të Kompaktit, Vlerësimi i Progresit për Periudhën Korrik 2017- Qershor 2018”, 2.

⁸⁴ Për vite me rradhë, Ambasada Amerikane ka luajtur një rol monitorues dhe mentorues në proceset për të zgjedhur anëtarët e rinj të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Kryeprokurorëve. Fatkeqësisht, ne besojmë se këto procese tani janë ‘prishur’ rrënjësisht. Atyre u mungon transparenca dhe i nënshtrohen konflikteve në rritje të interesit. Meqenëse përfshirja e mëtejme e Ambasadës mund të interpretohet keq si miratim i këtij sistemi të prishur, ne nuk do të marrim pjesë. Prokurorët duhet të zgjidhen në bazë të kualifikimeve të tyre, jo përkatësisë politike ose lidhjeve. Ndryshimet në kornizën ligjore që mbështet KPK-në janë të nevojshme për të rivendosur transparencën dhe drejtësinë e këtij sistemi. Prandaj, ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve të mbështesin përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë për të përfunduar menjëherë Rishikimin Funksional.

sistemin e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Si rrjedhojë, këta mekanizma nuk kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë themeluar.

Për këtë arsye, vettingu përkatësisht filtrimi i sistemit nga prokurorë dhe gjykatës pa integritet dhe me performancë të dobët si dhe aftësimi i mekanizmave të brendshëm për të kontrolluar funksionimin tutje të sistemit të drejtësisë në rast të ndonjë devijimi potencial, është edhe qëllimi kryesor i procesit të vettingut, pa të cilin proces, arritja e këtij qëllimi është e pamundur. Kjo për faktin se deri më tani, mekanizmat e brendshëm nuk kanë treguar qëndrueshmëri e as llogaridhënie dhe se të njëjtat nën kupolën e një sistemi të pa përgjegjshëm gjyqësor dhe prokurorial nuk mund të performojnë suksesshëm.

PËRFUNDIMI

Sistemi i drejtësisë në Kosovës, në veçanti ai gjyqësor dhe prokurorial vazhdojnë të karakterizohen me mungesë të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë si dhe me mungesë të llogaridhënies në sistem. Pothuajse për 20 vjet, që nga paslufta, sistemi i drejtësisë ka qenë i përfshirë në reforma të vazhdueshme, të cilat reforma ishin ndërmarrë me qëllim të krijimit të këtij sistemi, e gjithashtu me qëllim të rritjes së besimit dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Dokumenti lidhur me Modalitetet e llogaridhënies me përfshirjen e Vettingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë, fillimisht ka identifikuar sfidat kryesore nëpër të cilat ka kaluar dhe vazhdon të ballafaqohet sistemi i drejtësisë. Qëllimi i dokumentit të tillë, është skanimi i gjendjes dhe problemeve më të cilat ballafaqohet sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial në Republikën e Kosovës, si dhe parasheh modalitetet të cilat do të adresonin çështjet e besimit dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Realisht dokumenti i cili është i ndarë në 3 pjesë kryesore, përfshinë kornizën aktuale ligjore në bazë të së cilës organizohen dhe funksionojnë sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial, pastaj përfshinë sfidat dhe problemet kryesore të këtij sistemi dhe mundësitë e adresimit të tyre, për të përfunduar me 3 modalitetet kryesore si alternativa të cilat do të përmirësonin besimin dhe llogaridhënien në sistemin e drejtësisë dhe gjithashtu do të rrisnin efikasitetin e prokurorive dhe gjykatave.

Integriteti i gjykatësve dhe prokurorëve, llogaridhënia e tyre si dhe mungesa e rezultateve të mekanizmave disiplinor dhe atyre për vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe prokurorëve janë ndër problemet më të theksuara të përfshira në pjesën/kapitullin 2 të dokumentit, Sfidat e sistemit të drejtësisë - Mundësitë dhe pamundësitë e adresimit të sfidave. Numri i pamjaftueshëm më gjykatës dhe prokuror, ndryshimet e vazhdueshme ligjore dhe riorganizimi i gjykatave dhe prokurorive, numri i madh i lëndëve dhe vjetërsimi i tyre si dhe rastet e ndikimeve politike dhe të konfliktit të interesit, janë probleme të tjera të përfshira në kuadër të këtij kapitulli.

Ndër arsytet e mungesës së rezultateve, veçanërisht sa i përket mungesës së rezultateve në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë mbetet ndikimi i politikës dhe grupeve të interesit në sistemin e drejtësisë. Cilësime të tilla të raporteve ndërkombëtare dhe atyre vendore për sistemin kosovar të drejtësisë janë të vazhdueshme, me ç'rast në dokument janë përfshirë edhe raste konkrete të cilat demonstrojnë ndikimet e tilla në drejtësi.

Republika e Kosovës, për një kohë të gjatë është ballafaquar me numër të madh të lëndëve të pazgjidhura, të cilat janë shtuar nga viti në vit. Formimi i profesioneve të lira, me këtë rast edhe përmbartimi privat, pastaj rritja graduale e numrit të gjykatësve, kishte filluar të

lehtësojë punën e gjykatave me numrin e lëndëve. Por sidoqoftë, numri i madh i lëndëve, ka vazhduar të ketë pasojat e saj në sistemin e drejtësisë.

Tutje dokumenti identifikon se sistemi i drejtësisë në Kosovë, gjykatat dhe prokuroritë, vazhdojnë të ballafaqohen me mungesë të performancës kualitative të prokurorëve dhe gjykatësve gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre dhe gjithashtu, me mungesë të rezultateve konkrete të mekanizmave për vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe prokurorëve në kuadër të KGjK dhe KPK.

Sa i përket shkeljeve të afateve ligjore procedurale në procedura hetimore dhe gjyqësore, janë identifikuar raste të mos-respektimit të afateve ligjore të përcaktuara me dispozita ligjore, përkatësisht me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Shkelje të tilla në disa raste të trajtuara nga gjykata shkojnë deri në mbi 1500 ditë me vonesë, e cila gjë natyrisht se bie në kundërshtim me vet Kodin e Procedurës dhe konventat ndërkombëtare. Zgjatja e një procesi gjyqësor ndodh edhe në procedurën civile madje problematike shihet edhe në vendimet e shkallëve gjyqësore, e cila në fund rezulton me vet shkelje të të drejtave të palëve për një gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Në fund dokumenti sjellë 3 opsione/alternativa, në kuadër të reformës për rritje të besimit dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Opsioni i I-rë i cili përmban Status Quo-në e sistemit të drejtësisë, konstaton rregullimin aktual ligjor në bazë të të cilave organizohet dhe funksionon sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor, si dhe konstaton problemet kryesore me të cilat ballafaqohet gjyqësori dhe prokuroria. Siç u përmend më lartë, për momentin ndër mangësitë më të theksuara të sistemit të drejtësisë, konsiderohet mungesa e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mangësitë profesionale të tyre. Ky qalim në integritet dhe performancë, vlerësohet të jetë i afektuar nga ndikimet e politikës, pastaj ekzistimi i grupeve të interesit, si dhe konflikti i interesit që konsiderohet i pranishëm në sistemin e drejtësisë.

Pra, problemi kryesisht qëndron se në praktikë llogaridhënia dhe integriteti i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk janë në nivelin që normativa ligjore e Republikës së Kosovës e proklamon të nevojshme.

Opsioni i II-të ofron disa ndryshime të nevojshme ligjore të cilat do të ndikonin në përmirësimin e besimit dhe të llogaridhënies në veçanti në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial. Në ndryshimet e tilla përfshihen kryesisht por nuk kufizohet në rregullimin e përgjegjësive disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve dhe ndërtimin e një mekanizmi efikas të verifikimit të vazhdueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve dhe vlerësimin e performancës së tyre.

Opsioni i III-të, 'mix', thërret në adresimin e përmirësimit të gjendjes së sistemit të drejtësisë si përmes aprovimit dhe zhvillimit të *vetingut*, ashtu edhe përmes ndërhyrjeve të tjera ligjore

dhe operative që adresojnë elementet e tjera ku stagnon llogaridhënia, performanca dhe efikasiteti i atyre që vënë drejtësinë.

Opsioni i IV-të i cili përfshinë Vettingun, ofron një reformë më rrënjësore që përfshinë verifikimin e integritetit të gjykatësve dhe të prokurorëve. Vettingu është procesi përmes të cilit vlerësohet dhe verifikohet integriteti, performanca dhe etika e gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, përfshirë KGJK-në dhe KPK-në. Opsioni i tillë konstaton se përmes procesit të vetingut, synohet të arrihen: Depolitizimi i sistemit të drejtësisë, De influencimi i sistemit të drejtësisë nga grupet e interesit, Fuqizimi i sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës, Ngritja e cilësisë profesionale të sistemit të drejtësisë, Ngritja e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, Ngritja e rezultateve dhe performancës kualitative në sistemin e drejtësisë, Ngritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, Ngritja e transparencës në sistemin e drejtësisë , Fuqizimi i mekanizmave të brendshëm të vetëkontrollit në sistemin e drejtësisë, Arritja e një drejtësie efikase dhe efektive, ku të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Përkundër reformave të vazhdueshme, sistemi i drejtësisë në Kosovë konsiderohet si një nga hallkat më të brishta të të funksionimit të shtetit, i cili karakterizohet me mungesë të rezultateve dhe llogaridhënies, lehtë i ndikueshem nga politika si dhe me mungesë të theksuar të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.